




Funded by the
European Union



**MBËSHTETJA E VIKTIMAVE TË DHUNËS
ME ARMË NË BALLKANIN PERËNDIMOR:
PËRMBLEDHJE E SHKURTËR DHE REKOMANDIME**

Ky botim paraqet një version të shkurtuar të studimit të kryer nga SEESAC midis majit dhe shtatorit të vitit 2024, në bashkëpunim me Shoqatën e Viktimologjisë të Serbisë. Informacioni në raport bazohet në kuadrin ligjor në fuqi në kohën e përfundimit të studimit. Kjo përmbledhje e shkurtër integron të dhënat dhe analizat nga studimi, të plotësuara nga të dhënat e Raportit të Monitorimit të Dhunës me Armë dhe literatura përkatëse mbi dhunën me armë, të drejtat e viktimave dhe shërbimet si për viktimat e drejtpërdrejta, ashtu edhe për ato jo të drejtpërdrejta. Në fund të këtij dokumenti paraqiten rekomandimet paraprake të politikave, të formuluarat përmes një rishikimi gjithëpërfshirës të dokumentacionit dhe studimit fillestar empirik.

Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) është iniciativë e përbashkët e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR), e financuar nga Bashkimit Evropian (BE), e cila ka për qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale për kontrollin dhe pakësimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, duke kontribuar kështu në rritjen e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Ky botim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, nëpërmjet projektit *Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor*, të financuar nga Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II).

Për më shumë informacion, kontaktoni:

Drejtuesen e SEESAC

Bulevar Zorana Đinđića 64, 11000, Beograd, Serbi

Tel: +381 11 415 5300

www.seesac.org

Redaktimi: Vesna Cipruš

Përkthimi: AlbaGlobal Group

Dizajni dhe paraqitja në ueb: Methods Consulting

ISBN-978-68-7728-405-3

© SEESAC 2025 - Të gjitha të drejtat të rezervuara

Deklaratë për mohimin e përgjegjësisë: Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë pikëpamjet e UNDP-së, të KBR-së apo të BE-së. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen nga ana e UNDP-së, KBR-së apo BE-së të: 1) statusit ligjor të një vendi, territori ose zone apo të autoriteteve apo grupeve të tij të armatosura; ose 2) përcaktimit të vijave kufitare ose kufijve të tij.

Falënderime

Analiza cilësore bazohet në njohuri të vlefshme nga ekspertë dhe specialistë të mbështetjes së viktimave nga institucione të ndryshme të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë ekspertë ligjorë, psikologë, punonjës socialë dhe profesionistë të mbështetjes së viktimave nga institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile. Falënderojmë veçanërisht konsulentet e SEESAC-ut nga Shoqata e Viktimologjisë e Serbisë: Dr. Sanja Čopić, Dr. Mirjana Dokmanović, Jasmina Nikolić, Milica Luković Radaković dhe Mirela Osmanović, të cilat përgatitën raportin paraprak bazuar në analizën profesionale të të dhënave të marra nga gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, si edhe bashkëpunëtorët e tyre që punuan për mbledhjen e të dhënave në juridiksionet e përfshira në këtë hulumtim: Valmora Gogo, Dajana Dobrozi, Gentiana Murati, Maja Raičević dhe Prof. Dr. Nataša Peovska. Analiza është pasuruar gjithashtu me kontributet dhe njohuritë e vlefshme të anëtarëve të tjerë të ekipit të SEESAC, konkretisht: Alain Lapon, Juliana Buzi, Dragan Božanić, Tatjana Višacki, dhe Violeta Gaši.



PËRMBAJTJA

AKRONIME DHE SHKURTIME	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
1. HYRJE	11
1.1. Ndikimi unik i dhunës me armë	12
1.2. Dhuna me armë: Sfida e sigurisë dhe zhvillimit	14
2. KUADRI NORMATIV NDËRKOMBËTAR	21
2.1. Kuadri i të drejtave të viktimave	21
2.2. Përshkrimi i të drejtave të viktimave siç përshkruhet në Instrumentet ligjore kryesore rajonale	25
2.3. Kuadri i kontrollit të AVL-ve	31
3. PANORAMA E PËRGJITHSHME E KUADROVE LIGJORE NË JURIDIKSIONET E BALLKANIT PERËNDIMOR	34
3.1. Përkufizimi ligjor i termit “viktimë” - Karakteristikat e përbashkëta	34
3.2. Qasje specifike sipas juridiksioneve	35
3.3. Të drejtat e viktimave të dhunës me armë: Analizimi fillestar i mangësive	37
3.3.1. Karakteristikat e përbashkëta të identifikuara në të gjithë rajonin	37
3.3.2. Faktorët specifikë sipas juridiksioneve	38
4. NJOHURI EMPIRIKE MBI SHËRBIMET E MBËSHTETJES SË VIKTIMAVE NË TË GJITHË BALLKANIN PERËNDIMOR	41
4.1. Ofruesit e shërbimeve të mbështetjes së viktimave: Statusi, misioni dhe kapacitetet . . .	43
4.2. Një panoramë e përgjithshme e mbështetjes për viktimat e krimit në vitin 2023	44
5. SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT NË OFRIMIN E MBËSHTETJES PËR VIKTIMAT E DHUNËS SË LIDHUR ME ARMËT E ZJARRIT	46
6. REKOMANDIME	50
FJALORI I TERMAVE	55
LITERATURA	58



AKRONIME DHE SHKURTIME

AVMP | Platforma e Monitorimit të Dhunës me Armë

KE | Këshilli i Evropës

KBR | Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal

OShC | Organizatat e Shoqërisë Civile

BE | Bashkimi Evropian

IT | Instrumenti Ndërkombëtar i Gjurmimit

OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

AVL | Armët e vogla dhe të lehta

SEESAC | Zyra Qendrore e Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta

PV | Programi i Veprimit për Parandalimin, Luftën dhe Eliminimin e Tregtisë së

UNDP | Paligjshme të AVL-ve

OKB | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

VDS | Organizata e Kombeve të Bashkuara Shoqata e Viktimologjisë e Serbisë (Viktimološko društvo Srbije)



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky botim paraqet gjetjet kryesore nga studimi i kryer nga SEESAC në bashkëpunim me Shoqatën e Viktimologjisë të Serbisë, duke u fokusuar në gjashtë juridiksione të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova¹, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Studimi u krye midis majit dhe shtatorit të vitit 2024, duke u fokusuar te një fushë kritike ende e paeksploruar: shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës me armë jashtë kontekstit të një konflikti të armatosur. Kjo shënon përpjekjen e parë për të kuptuar karakteristikat kryesore të shërbimeve për viktimat e dhunës me armë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.²

Në nivelin global, por edhe në atë rajonal, dhuna me armë vijon të përbëjë një sfidë të konsiderueshme që ndikon te mirëqenia shoqërore dhe te zhvillimi njerëzor. Të dhënat nga [Platforma e monitorimit të dhunës me armë](#) e SEESAC tregojnë për pabarazi gjinore të thella në Ballkanin Perëndimor. Burrat preken në mënyrë disproporcionale nga dhuna me armë, duke përfaqësuar njëkohësisht shumicën e viktimave dhe të autorëve. Vetëm gjatë vitit 2024, burrat përfaqësonin 80% të të gjitha viktimave për të cilat specifikohet gjinia, duke përbërë shumicën dërrmuese të vdekjeve të shkaktuara nga armët e zjarrit. Burrat dominojnë edhe në rastet e plagosjeve, duke pasqyruar një ekspozim më të madh ndaj dëmtimeve të rënda fizike. Incidentet e lidhura me kërcënimet zbulojnë një dinamikë tjetër: ndonëse edhe këtu janë burrat ata që kryesojnë për nga numri, gratë përballen me një përqindje disproporcionalisht të lartë të kërcënimeve me armë zjarri në raport me përfaqësimin e tyre të përgjithshëm. Burrat përbënin 98% të autorëve në incidente të lidhura me armët e zjarrit, një përqindje që ka mbetur e pandryshuar me kalimin e kohës, ndërsa gratë përbënin 20% të viktimave dhe vetëm 2% të autorëve. Shkalla e dhunës me armë zjarri është e theksuar në mbarë rajonin: në vitin 2024, pati 113 njerëz të vrarë, 358 të plagosur dhe 387 të kërcënuar në incidente me armë zjarri. Dhuna me armë prek kryesisht të rinjtë midis moshës 19 dhe 35 vjeç.

Dhuna në familje rezultoi në numrin më të lartë të vdekjeve në të gjitha kontekstet, duke ndikuar në numrin disproporcional të grave. Midis viteve 2019 dhe 2024, incidentet me armë zjarri në mjediset familjare u rritën në mënyrë të qëndrueshme, duke shënuar një rritje prej 81%. Gjatë të njëjtës periudhe, numri i viktimave u rrit me 85%. Incidentet e lidhura me armët e zjarrit ku përfshiheshin

¹ Për sa i përket Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, referencat për Kosovën kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999). Për sa i përket Bashkimit Evropian, ky emërtim nuk cenon qëndrimet lidhur me statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) dhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

² Botimi integron të dhënat dhe analizat nga studimi fillestar, të plotësuar me njohuri nga Raporti i Monitorimit të Dhunës me Armë dhe literatura akademike aktuale. Informacioni i përfshirë mbi kuadrin ligjor pasqyron statusin në kohën e përfundimit të studimit. Vini re se pjesa më e madhe e tekstit në këtë përmbledhje është marrë nga studimi i pabotuar i SEESAC *Analiza mbi Mbështetjen e Viktimave të Dhunës me Armë në Ballkanin Perëndimor*, i kryer përmes Shoqatës së Viktimologjisë të Serbisë. *Citimet në shënimet e mëposhtme në fund të faqes janë marrë fjalë për fjalë: 7,8, 22-24, 36, 38-40, 43, 47, 55, 56, 62-65.*



partnerët intimë u dyfishuan dhe gratë përbënin 98% të të gjitha viktimave në rastet e regjistruara. Kështu, ndonëse incidentet e dhunës në familje që përfshinin armë zjarri ishin shumë më të vogla në numër sesa ato në kontekste kriminale, mosmarrëveshjet në publik ose të shtënat për shkaqe të papërcaktuara, ato rezultuan në numrin më të lartë të vdekjeve, duke e bërë dhunën në familje kontekstin më vdekjeprurës për gratë në rastet që përfshinin armë zjarri.³

Të dhënat tregojnë nevojën për ndërhyrje për të adresuar çështjen e dhunës me armë, duke siguruar qasje në shërbime të përshtatshme për viktimat e dhunës me armë. Pavarësisht hapave të rëndësishëm të bërë nga juridiksionet e Ballkanit Perëndimor në forcimin e kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe luftën kundër dhunës me armë, çështja e shërbimeve mbështetëse për viktimat ende nuk është adresuar në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse.

Viktimat e krimeve të dhunshme, duke përfshirë dhunën me armë zjarri, kanë të drejtën të përfitojnë mbështetje që plotëson nevojat e tyre të ndryshme, jo vetëm ato që lidhen me ndjekjen penale. Historikisht, në fokus të publikut dhe politikës ka qenë kryesisht dënimi i autorit.⁴ Kohët e fundit, politikëbërësit po kuptojnë gjithnjë e më shumë se mbështetja gjithëpërfshirëse e viktimave është thelbësore për një sistem drejtësie të drejtë dhe efektiv.

Ekzistojnë një sërë instrumentesh ligjore ndërkombëtare dhe rajonale që rregullojnë mbështetjen për viktimat e dhunës. Këto instrumente ligjore, veçanërisht Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Shpërdorimit të Pushtetit dhe Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012, “Për përcaktimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimin” (Direktiva për të Drejtat e Viktimave) ofrojnë njohuri thelbësore mbi të drejtat e viktimave. Ato parashikojnë se shërbimet mbështetëse duhet të jenë të aksesueshme për viktimat para, gjatë dhe për një periudhë të përshtatshme pas procedurave penale, pavarësisht nga raportimi zyrtar ose statusi ligjor. Këto shërbime duhet të jenë të përqendruara te viktima, të mirorientuara dhe të integruara, duke shmangur rrezikun e riviktimizimit, viktimizimit dytësor, intimidimit, kërcënimeve ose hakmarrjes së mundshme. Sipas Direktivës për të Drejtat e Viktimave, shërbimet për mbështetjen e viktimave duhet t’u kushtojnë vëmendje të veçantë nevojave të posaçme të viktimave që kanë pësuar dëme të konsiderueshme për shkak të ashpërsisë së krimin. Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh pasojat e rënda të dhunës me armë për të gjitha viktimat e prekura drejtpërdrejt dhe tërthorazi.

Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e viktimave është thelbësore, veçanërisht midis profesionistëve në institucione dhe shërbime që nuk janë zakonisht të lidhura me mbështetjen e viktimave. Policia dhe shërbimet ligjore luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e perceptimeve të viktimave për mbështetjen e disponueshme, veçanërisht në periudhën që pason kryerjen e një krimi. Ato konsiderohen shpeshherë si një sistem i vetëm dhe një përvojë negative me një pjesë të vetme të këtij sistemi, si p.sh. me forcat e rendit, mund të çojë në shkëputjen e viktimës nga shërbimet e tjera mbështetëse.

Edhe pse ekziston një angazhim i qartë për mbështetjen e viktimave në gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor të përfshira në studim, arritja e përafrimit të plotë me standardet ndërkombëtare dhe të

³ SEESAC (2025). *Incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje – Ballkani Perëndimor, 2019–2024*. Mund ta gjeni në: [IN_FOCUS_Domestic_violence_Western_Balkans_2019-2024_w.pdf](#)

⁴ Është e rëndësishme të kuptohet se autorëve duhet t’u ofrohen mundësi për rehabilitim si një mjet për të parandaluar recidivizmin. Megjithatë, çështja e rehabilitimit është jashtë objektivit të kësaj përmbledhjeje.



BE-së mbetet një proces i vazhdueshëm që kërkon vëmendje të veçantë. Viktimat e incidenteve me armë zjarri në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi kanë të njëjtin status ligjor si viktimat e veprave të tjera penale, gjë që mund të sjellë mangësi për sa i përket mbrojtjes së duhur. Në rajon ka ende një përkufizim ligjor jo të njëtrajshëm të “viktims”, i cili nuk është në përputhje me Direktivën e BE-së për të Drejtat e Viktimave dhe nuk përfshin plotësisht viktimat jo të drejtpërdrejta, siç janë anëtarët e rrethit të ngushtë familjar dhe personat nën varësi, siç përcaktohen nga standardet ndërkombëtare.⁵ Për më tepër, kuadri ekzistues rajonal i kontrollit të AVL-ve përmban vetëm referenca të kufizuara për viktimat dhe nuk e përmend shprehimisht nevojën për shërbime të dedikuara për personat e prekur nga dhuna me armë. Duke qenë se personeli i sektorit të sigurisë është shpeshherë i pari që ndërhyr në rastet e incidenteve të lidhura me armët e zjarrit, është thelbësore që politikat dhe praktikat e kontrollit të AVL-ve të integrojnë aspektet e të drejtave të viktimave për të siguruar dhënien e informacionit në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme, si dhe parandalimin e riviktimizimit dhe viktimizimit dytësor.

Shërbimet aktuale të mbështetjes së viktimave në rajon ofrohen nga një gamë e larmishme institucionesh publike, organizatash të shoqërisë civile (OSHC) dhe agjencish të pavarura. Ka disa sfida kritike që pengojnë ofrimin e duhur të mbështetjes për viktimat e dhunës me armë zjarri. Këtu përfshihet mungesa e shërbimeve të përshtatura në mënyrë specifike për nevojat unike të viktimave të dhunës me armë, natyrën e fragmentuar të sistemeve ekzistuese të mbështetjes së viktimave dhe mbledhjen jo të njëtrajshme të të dhënave specifike për këtë formë dhune. Kufizimet financiare paraqesin një pengesë të konsiderueshme, veçanërisht për ofruesit e shërbimeve të OShC-ve, pasi shpeshherë ato varen në një shkallë të konsiderueshme nga financime të pasigurta dhe të bazuara në projekte.⁶ Gjithashtu, OShC-të rrallëherë përfshihen në konsultime kur bëhet fjalë për hartimin e politikave në lidhje me kontrollin e AVL-ve dhe shërbimet e mbështetjes së viktimave.

Për të rritur disponueshmërinë dhe cilësinë e mbështetjes për viktimat e armëve të zjarrit, në fund të këtij botimi jepen një sërë rekomandimesh. Është e nevojshme që të përditësohen kuadrot ekzistuese ligjore dhe politike për të arritur përafrimin e plotë me standardet ndërkombëtare. Kjo përfshin miratimin e një përkufizimi gjithëpërfshirës të “viktims” që të mbulojë si viktimat e drejtpërdrejta, ashtu edhe ato jo të drejtpërdrejta, sigurimin e një terminologjie të njëtrajshme dhe vendosjen e një detyrimi të qartë ligjor për autoritetet për të lehtësuar referimin te shërbimet e mbështetjes së viktimave.

Gjithashtu, është me rëndësi thelbësore zbatimi i programeve të qëndrueshme dhe të aksesueshme të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve për profesionistët në të gjithë sektorët përkatës, duke filluar nga policia, e cila është shpeshherë pika e parë e kontaktit jo vetëm për viktimat, por edhe për ofruesit e kujdesit shëndetësor, oficerët e policisë gjyqësore dhe OShC-të përkatëse. Këto programe duhet t'i ndihmojnë oficerët e parë në vendngjarje dhe ofruesit e shërbimeve që të kuptojnë më mirë nevojat e viktimave dhe t'i pajisin ata me aftësitë e duhura për të vlerësuar dhe adresuar nevojat unike të viktimave të dhunës me armë zjarri dhe familjeve të tyre.

⁵ Ndonëse Direktiva për të Drejtat e Viktimave nuk ka fuqi ligjore detyruese për shtetet joanëtare, përafrimi me *acquis* të BE-së, e cila përfshin edhe këtë direktivë, përbën kusht për anëtarësimin në BE.

⁶ Për informacione të mëtejshme mbi rolin e OShC-ve dhe çështjet që lidhen me qëndrueshmërinë e shërbimeve për viktimat të ofruara nga OShC-të, shih Nikolić-Ristanović, V., Čopić, S., Nikolić, J., Šaćiri, B. (2018) *Podrška žrtvama u izabranim državama Balkana: Komparativna perspektiva*. Beograd: Viktimološko društvo Srbije (*Mbështetja për viktimat në shtete të përzgjedhura të Ballkanit: Një perspektivë krahasuese*. Beograd: Shoqata e Viktimologjisë e Serbisë. Përmbledhja ekzekutive e disponueshme në anglisht). Mund ta gjeni në: [Podrska_Zrtvama_Analiza.indd](#)




Është mjaft e rëndësishme që, së bashku me mbledhjen sistematike të të dhënave të ndara mbi viktimat e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të dhunës me armë zjarri, të zhvillohen edhe kuadro të forta monitorimi dhe vlerësimi.

Së fundi, nxitja e bashkëpunimit rajonal midis juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor është thelbësore për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe shfrytëzimin e rrjeteve ekzistuese të sektorit të sigurisë për të lehtësuar dhe përshpejtuar përafrimin me standardet ndërkombëtare për mbështetjen e viktimave.

Duke përditësuar në mënyrë proaktive kuadrot ligjore, duke forcuar kapacitetet institucionale, duke advokuar për financim të qëndrueshëm për ofruesit e shërbimeve, duke siguruar akses në trajnime të specializuara dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërinstitucional dhe rajonal, juridiksionet e Ballkanit Perëndimor do të jenë të mirëpozicionuara për të krijuar në mënyrë progresive një sistem mbështetës më gjithëpërfshirës, të përqendruar te viktimat dhe të informuar rreth traumave për të gjithë individët e prekur nga dhuna me armë, që është plotësisht në përputhje me Direktivën e BE-së për të Drejtat e Viktimave.

Kjo përmbledhje fillon me një **hyrje** që përshkruan karakteristikat dhe ndikimet e veçanta të dhunës me armë. Ajo paraqet të dhënat më të fundit nga Ballkani Perëndimor, duke theksuar rëndësinë dhe afatet kohore të studimit të fokusuar te mbështetja për viktimat e dhunës me armë. **Kapitulli i dytë** përshkruan kuadrin normativ ndërkombëtar në lidhje me mbështetjen për viktimat, duke përfshirë direktivat kryesore të BE-së. Ai ofron gjithashtu një përmbledhje të shkurtër të kuadrove ndërkombëtare dhe rajonale të kontrollit të AVL-ve, duke vlerësuar shkallën në të cilën ato përfshijnë aspektet e mbështetjes për viktimat. **Kapitulli i tretë** shqyrton kuadrin ligjor përkatës brenda juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor, duke theksuar mangësitë në përafrimin me standardet ndërkombëtare. **Kapitulli i katërt** paraqet gjetjet orientuese nga studimet empirike të kryera në gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, duke nxjerrë në pah çështjet kryesore që lidhen me mbështetjen për viktimat sipas perceptimit të ofruesve të shërbimeve. **Kapitulli i pestë** përmbledh sfidat kryesore në ofrimin e shërbimeve. Së fundi, **kapitulli i gjashtë** ofron një sërë rekomandimesh të zbatueshme që rrjedhin nga gjetjet e studimit dhe një rishikim të mëtejshëm të literaturës aktuale.



HYRJE



1. HYRJE

Dhuna me armë mund të përkufizohet si përdorimi i qëllimshëm, i kërcënuar ose faktik i armëve për të shkaktuar vdekjen ose plagosjen. Ajo mund të marrë një sërë formash që variojnë nga dhuna politike tek ajo kriminale dhe ndërpersonale, dhe shfaqet në një mori kontekstesh. Ç'është më e rëndësishmja, ajo shtrihet përtej dëmit fizik, duke përfshirë edhe dëmin psikosocial dhe ndikimin e tij të thellë negativ të zhvillimi.⁷

Si një fenomen shumëdimensional, dhuna me armë ka ndikime të thella jo vetëm në situatat e konflikteve të armatosura, por edhe në kontekstet e krimit të organizuar dhe krimeve të vogla, dhunës nga partneri intim dhe dhunës së lidhur me familjen, dhunës së bandave dhe formave të tjera të dhunës ndërpersonale – që shpesh shfaqen brenda shoqërive përgjithësisht paqësore. Ndikimi i keqpërdorimit të AVL-ve është shkatërrues për viktimat, familjet dhe komunitetet e tyre. Kur ruhen në mënyrë jo të përshtatshme, AVL-të mund të rrezikojnë fëmijët dhe personat e tjerë që bien në kontakt me to. Kur keqpërdoren gjerësisht në një zonë të caktuar, ato mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme për jetën, mjetet e jetesës dhe shëndetin e individëve, familjeve dhe komuniteteve dhe mund të krijojnë një mjedis të frike dhe pasigurie të thellë që cenon mirëqenien dhe zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor.⁸

Si subjekte përgjegjëse, juridiksionet janë të detyruara në bazë të kuadrove ligjore ndërkombëtare që të zbatojnë masat parandaluese dhe të ofrojnë mbështetje gjithëpërfshirëse për të mbijetuarit, familjet e tyre dhe të gjithë personat e prekur nga dhuna me armë. Një aspekt themelor i kësaj mbështetjeje është e drejta e viktimës për shërbime konfidenciale pa pagesë për mbështetjen e viktimave, të aksesueshme para, gjatë dhe për një kohë të përshtatshme pas procedurave penale, pavarësisht nga raportimi zyrtar ose statusi ligjor. Këto shërbime duhet të jenë gjeografikisht të aksesueshme dhe të mbulojnë edhe viktimat jo të drejtpërdrejta, siç janë anëtarët e familjes, duke përfshirë edhe fëmijët. Ato janë kritike për t'u mundësuar viktimave akses në të drejtat e tyre, duke përfshirë marrjen e ndihmës mjekësore të menjëhershme, mbështetjen e duhur psikologjike dhe marrjen e informacionit ose referimeve në shërbime të tjera të specializuara, të tilla si akomodimi i sigurt sipas nevojës dhe mbështetja e përshtatur për viktimat e cënueshme.⁹

Për të ofruar një përmbledhje fillestare të shërbimeve ekzistuese të mbështetjes për viktimat në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Kosovën,

7 Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. *Nxitja e zhvillimit përmes reduktimit dhe parandalimit të dhunës me armë*. Nju Jork, 2009

8 Veprimi i Koordinuar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Armët e Vogla (CASA) (2015). *Standardi Ndërkombëtar për Kontrollin e Armëve të Vogla. Rregullorja kombëtare për aksesin e civilëve në armët e vogla dhe të lehta*.

9 Një listë gjithëpërfshirëse e të gjitha shërbimeve që duhet të jenë të disponueshme sipas standardeve ndërkombëtare jepet në kapitullin e dytë.



Bosnjë-Hercegovinën dhe Shqipërinë, SEESAC, në bashkëpunim me Shoqatën e Viktimologjisë të Serbisë (Viktimološko društvo Srbije – VDS), kreu një studim i cili shënoi përpjekjen e parë për një analizë rajonale të këtij lloji.¹⁰ Qëllimi kryesor i studimit empirik ishte të kuptohej gjendja aktuale e mekanizmave mbështetës në dispozicion dhe të identifikoheshin boshllëqet ekzistuese, duke hedhur kështu bazat për rekomandime të bazuara në prova për të forcuar shërbimet e mbështetjes për viktimat. Të dhënat u mbledhën përmes një pyetësi anketimi të shpërndarë tek institucionet publike, agjencitë e pavarura dhe OShC të përzgjedhura. Anketa arriti një nivel përgjigjeje prej mbi 41%, duke rezultuar në një kampion përfundimtar prej 182 subjektsh. Nga këto, 58% ishin institucione publike.

Të dhënat e mbledhura u analizuan për të formuluar gjetjet. Vini re se të dhënat empirike të paraqitura në këtë përmbledhje të shkurtër nuk duhet të konsiderohen si përfundimtare, për shkak të niveleve të pabarabarta të përgjigjes nga institucionet dhe OShC-të në të gjashtë juridiksionet. Edhe pse jo përfundimtare, të dhënat ofrojnë njohuri orientuese të cilat, së bashku me një rishikim gjithëpërfshirës të literaturës përkatëse, kanë informuar rekomandimet e paraqitura në fund të përmbledhjes.

1.1. Ndikimi unik i dhunës me armë

Natyrë shkatërruese dhe shkallë e gjerë e pasojave vdekjeprurëse dhe jovdekjeprurëse të incidenteve që përfshijnë armët e zjarrit e veçojnë përvojën e viktimave të dhunës me armë. Lëndimet jofatale me armë zjarri mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme dhe afatgjata të shëndeti fizik dhe të mjetet e jetesës së individëve. Prania dhe disponueshmëria e armëve të zjarrit janë faktorë të njohur rreziku për dhunën në familje.¹¹

Kur një person bie viktimë e një krimi të dhunshëm, siç është dhuna me armë zjarri, është me rëndësi thelbësore që të plotësohen nevojat e tij të ndryshme, jo vetëm ato që lidhen me rezultatet e ndjekjes penale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke qenë se jo të gjitha rastet mund të ndiqen penalisht, siç janë rastet kur autori ka vdekur, nuk është kapur ende apo është person i mitur. Gjithashtu, shumë raste mund të mbeten të raportoara. Sipas studimit të fundit të Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore, viktimat zgjedhin të mos raportojnë për shkak të frikës se nuk t'i besojnë, mungesës së besimit të policia ose institucionet e drejtësisë dhe frikës nga hakmarrja ose viktimizimi i mëtejshëm.¹² Të dhënat empirike nga një kampion prej mbi 110 000 të anketuarish tregojnë se grupe të veçanta të viktimave, siç janë gratë viktimat të dhunës nga partneri intim, rrallëherë e raportojnë dhunën në polici, ku vetëm 13,9% e atyre që gjatë jetës së tyre kanë qenë viktimat të dhunës fizike ose kërcënimeve apo dhunës seksuale raportojnë në polici.¹³ Sipas anketës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim

¹⁰ Studimet mbi shërbimet për viktimat e dhunës me armë janë të pakta në rang global, duke përfshirë edhe vendet e BE-së. Ndonëse VDS kreu një analizë krahasuese të kuadrove ligjore në pesë juridiksione në vitin 2018 (Ristanoviç-Nikoliç, V. *Support for Victims in Selected Balkan States: A Comparative Perspective*), ky studim i porositur nga SEESAC është i pari që ndërthur një përmbledhje të kuadrove ligjore me një analizë empirike të disponueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të mbështetjes për viktimat, veçanërisht brenda Ballkanit Perëndimor.

¹¹ Konventa për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), në nenin 51 të saj, i detyron shtetet palë të vlerësojnë rrezikun e vdekshmërisë, duke marrë parasysh nëse autori i veprës zotëron ose ka akses në armë zjarri, gjë që rrit rrezikun për shtet.

¹² EU Agency for Fundamental Rights. (2024). *Stepping up the response to victims of crime: FRA's findings on challenges and solutions*. Mund ta gjeni në: <https://fra.europa.eu/en/publication/2024/stepping-response-victims-crime>

¹³ Studimi për dhunën me bazë gjinore në BE (2024), që citohet në botimin e Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore - *Stepping up the response to victims of crime: FRA's findings on challenges and solutions*. Vini re se të dhënat nga anketimi përfshijnë forma të ndryshme dhune. Megjithatë, ato janë të rëndësishme veçanërisht në kontekstin e nënraportimit të kërcënimeve që përfshijnë armët e zjarrit.



në Evropë (OSBE) mbi dhunën ndaj grave, përqindja e grave që raportojnë dhunën është edhe më e ulët në Evropën Juglindore.¹⁴ Anketa e OSBE-së dokumentoi se edhe pas incidenteve më të rënda të dhunës fizike dhe/ose seksuale, në shumicën e rasteve policia nuk është informuar. Gjithashtu, viktimat kanë shumë më tepër gjasa që t'i raportojnë incidentet më të rënda kur ato kryhen nga një jopartner se sa nga një partner intim. Dhuna e kryer nga partnerët aktualë ka më shumë gjasa të mos raportohet, dhe kjo është veçanërisht e vërtetë kur bëhet fjalë për kërcënimet me armë zjarri. Në rastet e rralla kur gratë detyrohen të përdorin armë zjarri në kontekstin e dhunës nga partneri intim, ka shpeshherë një histori të abuzimit në familje nga partneri i tyre.¹⁵

Historikisht, në fokus të vëmendjes së publikut dhe politikës ka qenë kryesisht dënimi i autorit. Megjithatë, gjithnjë e më shumë po kuptohet se viktimat kërkojnë forma të ndryshme ndihme dhe se mbështetja gjithëpërfshirëse e viktimave është thelbësore për një sistem drejtësie të drejtë dhe efektiv.¹⁶

Ndonëse ndikimi i dhunës me armë është unik dhe veçanërisht i rëndë, është e rëndësishme të mbahet parasysh se viktimat nuk janë një grup homogjen. Ndikimi i krimit varion ndjeshëm në bazë të faktorëve të tillë si mosha, gjinia, shëndeti dhe statusi social, ekzistenca e rrjeteve mbështetëse në familjen dhe komunitetin e viktimave, si dhe ndërveprimet e tyre të mëparshme me sistemet e sigurisë dhe të drejtësisë. Prandaj, shërbimet e mirëprojektuara duhet të pasqyrojnë këto përvoja, rrethana personale dhe karakteristika të shumëllojshme që kërkojnë përpjekje të koordinuara nga një sërë agjencish. Qasjet universale janë shpeshherë të pamjaftueshme, pasi lënë pa zgjidhur nevoja kritike dhe pengojnë rikuperimin e viktimave.¹⁷

Rritja e ndërgjegjësisimit për nevojat e viktimave, veçanërisht mes ofruesve të shërbimeve që nuk janë perceptuar tradicionalisht si pjesë e mbështetjes së viktimave, është thelbësore. Policia dhe shërbimet ligjore luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e perceptimeve të viktimave. Ato konsiderohen shpeshherë si një sistem i vetëm dhe një përvojë negative me një pjesë të vetme të këtij sistemi, si p.sh. me forcat e rendit, mund të çojë në shkëputjen e viktimës nga shërbimet e tjera mbështetëse. Kjo thekson rëndësinë e ofrimit të shërbimeve të integruara dhe pa ndërprerje, për të shmangur viktimizimin dytësor dhe për të siguruar një reagim të bashkërenduar dhe të ndjeshëm, veçanërisht për viktimat e krimeve të lidhura me armët e zjarrit.¹⁸

Pasojat e dhunës me armë janë të ndryshme për secilën prej gjinive: gratë dhe fëmijët janë shpesh viktima, ndërsa burrat përbëjnë shumicën e autorëve dhe të vrarëve ose të plagosurve me armë zjarri.¹⁹ Frika dhe pasiguria e theksuar që buron nga incidentet me armë zjarri, veçanërisht nga të shtënat në masë në hapësira publike dhe shkolla, dhuna e përhapur në familje, vrasja, femicidi ose vrasjet e mbetura në tentativë që përfshijnë armë zjarri, cenojnë thellësisht mirëqenien e njerëzve dhe të komuniteteve.

14 OSBE. (2019). *Anketa e OSBE-së për dhunën ndaj grave: Raporti kryesor*. Anketa e OSBE-së u krye në vitin 2018 në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, Moldavi dhe Ukrainë. Për më shumë detaje, shihni: <https://www.osce.org/secretariat/413237>

15 De Schutter, A. (2023). *Family gun violence in the European Union*. Flemish Peace Institute. [2023/12/PROJECT_INSIGHT_-_Family_Gun_Violence_DEF_REV.pdf](https://www.flemishpeaceinstitute.org/2023/12/PROJECT_INSIGHT_-_Family_Gun_Violence_DEF_REV.pdf)

16 Ellard, R. & Campbell E. (2020). *Improving support for victims of crime: Key practice insights*, Centre for Innovative Justice, RMIT University

17 *Po aty*.

18 *Po aty*.

19 SEESAC (2024). *In Focus Armed Violence Monitor – Victims of firearms incidents in the Western Balkans*. Mund ta gjeni në: https://www.seesac.org/f/docs/in-focus-armed-violence-monitors_1/In-Focus-Armed-Violence-Monitor-on-Victims-of-Firearm-.pdf



1.2. Dhuna me armë: Sfida e sigurisë dhe zhvillimit

Në nivel global, kostot dhe efektet e dhunës me armë janë shumë më të mëdha në kontekste jokonfliktuale sesa në kontekste konfliktuale.²⁰ Nga pikëpamja ekonomike, kostot e mirëqenies të shkaktuara nga dhuna me armë janë të konsiderueshme dhe ndikojnë negativisht tek aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi. Sipas vlerësimeve, ato përfaqësojnë afërsisht 1,63 për qind të PBB-së globale.²¹ Dhuna me armë përshkallëzon pasigurinë brenda komuniteteve dhe është e lidhur ngushtë me varfërinë, zhvillimin e pamjaftueshëm dhe pabarazitë, duke përfshirë aksesin e pabarabartë në shërbimet thelbësore siç janë arsimi dhe kujdesi shëndetësor. Gjithashtu, ajo përmendet shpeshherë si arsyeja kryesore pse individët armatosen për vetëmbrojtje dhe mbrojtje të pronës.

Të dhënat zyrtare që lidhen me dhunën me armë zakonisht nuk përfshijnë pasojat jofatale të keqpërdorimit të armëve të zjarrit, megjithëse ndikimi i kësaj lloji dhune shkon përtej humbjes së jetës. Përveç dëmeve fizike që shpesh rezultojnë në lëndime që ndryshojnë cilësinë e jetës, efektet negative të psikikës e të mbijetuarve, si dhe tek anëtarët e familjes së tyre, përfshijnë dhimbjen, vuajtjen, çrregullimin e stresit akut, çrregullimin e stresit post-traumatik, frikën, turpin, zemërimin, agresivitetin dhe pasojat të tjera që janë edhe më afatgjata dhe shkatërruese nëse të mbijetuarit ose dëshmitarët janë të mitur.²²

Viktimat mund t'i ndiejnë këto efekte edhe në rastet kur arma e zjarrit përdoret për kërcënim. Gjithashtu, është dokumentuar gjerësisht se edhe thjesht prania e një arme zjarri përbën kërcënim dhe/ose dhunë psikologjike ndaj anëtarëve të familjes, bashkëshortëve ose partnerëve dhe e bën shtëpinë një vend më pak të sigurt.²³ Prania dhe disponueshmëria e armëve të zjarrit janë gjithashtu faktorë rreziku që lidhen me të shtënat në masë dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit brenda një konteksti familjar rrit rrezikun e pasojave fatale, veçanërisht femicidit.²⁴

²⁰ United Nations. *A New Era for Conflict and Violence*. New York, 2020. Mund ta gjeni në: [A New Era of Conflict and Violence](#)

²¹ *Po aty*.

²² Guay, S., Beaulieu-Prévost, D., Sader, J., Marchand, A. (2019). *A systematic literature review of early posttraumatic interventions for victims of violent crime*. *Aggression and violent behavior*; Andrews, B., Brewin, C. R., Rose, S., Kirk, M. (2000). *Predicting PTSD symptoms in victims of violent crime: the role of shame, anger, and childhood abuse*. *Journal of Abnormal Psychology*; Brewin, C. R., Andrews, B., Rose, S., Kirk, M. (1999). *Acute stress disorder and posttraumatic stress disorder in victims of violent crime*. *American Journal of Psychiatry*, sikurse citohet në studimin e pabotuar *Analiza mbi Mbështetjen e Viktimave të Dhunës me Armë në Ballkanin Perëndimor, SEESAC, 2004*

²³ Kivisto AJ, Porter M (2020). *Firearm use increases risk of multiple victims in domestic homicides*. *Journal of the American Academy Psychiatry Law*; Zeoli, A.M., Bonomi, A. (2015). *Pretty in Pink? Firearm Hazards for Domestic Violence Victims*. *Women's Health Issues*; Spasić, D. V. (2020). *Kontrola vatrenog oružja i rodno zasnovano nasilje: link koji nedostaje? (Firearms Control and Gender-Based Violence: A missing link?)*. *Teme*; Unijat, J. (2006). *Lako oružje-težak problem u Srbiji. (Light Weapons – Difficult Problem in Serbia)*. *Bezbednost Zapadnog Balkana*; Halilović, M. (2015). *Preživjele govore: Osvrt na odgovore krivičnog sistema na nasilje u porodici u Bosni i Hercegovini. (Survivors Speak: A Review of the Criminal Justice System's Responses to Domestic Violence in Bosnia and Herzegovina)*. *Atlantska inicijativa: Udruženje za promicanje euroatlantskih integracija BiH*; Čopić et al. (2022). *Vodič za mapiranje potreba žrtava, procenu rizika i zaštitu od nasilja u porodici*. *Beograd: Viktimološko društvo Srbije*, sikurse citohet në studimin e pabotuar *Analiza mbi Mbështetjen e Viktimave të Dhunës me Armë në Ballkanin Perëndimor, SEESAC, 2004*

²⁴ Pavlov, T. & Lacmanović, V. (2023). *Karakteristike i prevencija slučajeva femicida–suicida počinjenih vatrenim oružjem u intimnom partnerskom odnosu. (Characteristics and Prevention of Femicide-Suicide Cases Committed with Firearms in Intimate Partner Relationships)*. *Belgrade, UNDP*; Topalović, M. & Kolarski, Lj. (2024). *Kada dom postane bojište – femicid i nacionalna bezbednost Republike Srbije (When Home Becomes a Battlefield – Femicide and National Security of the Republic of Serbia)*. *Politika nacionalne bezbednosti*; Čopić, S., Dokmanović, M. (2022) *A snapshot of illicit firearm-trafficking and gun violence in Serbia*. In: *Pulling the Trigger: Gun Violence in Europe*. *Flemish Peace Institute, Brussels*; Geller, L.B., Booty, M., Crifasi, C.K. (2021) *The role of domestic violence in fatal mass shootings in the United States, 2014–2019*. In: *Epidemiology*; SEESAC (2024). *Incidentet me armë zjarri në Evropën Juglindore në vitin 2023*. Mund ta gjeni në: https://www.seesac.org/f/docs/Armed-Violence/Firearm-Incidents-in-SEE-2023_AVMP_-Infographic.pdf; SEESAC (2024). *In Focus Armed Violence Monitor – Victims of firearms incidents in the Western Balkans*. Mund ta gjeni në: <https://www.seesac.org/f/docs/>




Në nivel rajonal, dhuna me armë vijon të përbëjë një sfidë të konsiderueshme që ndikon te mirëqenia shoqërore dhe te zhvillimi njerëzor. Të dhënat nga [Platforma e Monitorimit të Dhunës me Armë \(AVMP\)](#) zbulojnë se burrat preken në mënyrë joproporcionale nga dhuna me armë, duke përfaqësuar shumicën e viktimave dhe të autorëve. Dhuna me armë prek kryesisht të rinjtë midis moshës 19 dhe 35 vjeç.

Sipas raportit *Monitorimi i Dhunës me Armë - "In Focus"*, në vitin 2022 u raportuan 1071 viktima nga 819 incidente me armë zjarri, gjë që theksoi natyrën e përhapur dhe kritike të kësaj sfide në Ballkanin Perëndimor.²⁵ Për sa i përket shpërndarjes gjeografike, Kosova doli si zona më e prekur me 343 viktima, duke përfaqësuar afërsisht një të tretën e totalit. Pas Kosovës, Shqipëria raportoi 202 viktima, Bosnjë-Hercegovina 178 viktima dhe Serbia 160 viktima.²⁶

Armët e dorës ishin lloji më i përdorur i armëve, të përfshira në 37% të incidenteve me viktima. Gjithashtu, një e treta e viktimave të shkaktuara nga armët e zjarrit ishin të përfshira në incidente me armë në zotërim të paligjshëm. Shumica e viktimave u raportuan në zonat urbane, me përjashtim të të shtënave aksidentale ose festive dhe incidenteve të lidhura me gjuetinë, të cilat ishin më të përhapura në mjediset rurale.²⁷

Për sa i përket moshës, dhuna me armë prekte kryesisht të rinjtë, ku 41% e viktimave ishin të moshave 19 deri në 35 vjeç, pasuar nga grupmosha 36 deri në 60 vjeç me 39%. Kjo tregon se gjasat për të rënë viktimë e dhunës me armë arrijnë kulmin në fillimet e moshës së rritur dhe zvogëlohen me rritjen e moshës, për të dyja gjinitë.²⁸

Grafiku 1: Viktimat sipas moshës – dy grupet mbizotëruese në rajonin e Ballkanit Perëndimor:



Rezultatet e këtyre incidenteve të dhunshme kanë qenë të ndryshme, duke variuar nga kërcënimet e deri te vdekjet. Një numër i konsiderueshëm prej 42% të viktimave janë përballur me kërcënime, pothuajse 30% kanë mbetur të plagosur dhe 12% kanë humbur jetën. Vlen të theksohet se shkalla e vdekjeve ka qenë pak më e lartë tek gratë (13%) krahasuar me burrat (12%), duke treguar një pabarazi gjinore për sa i përket ashpërsisë së pasojave, veçanërisht në kontekstin e dhunës në familje. Burrat

[in-focus-armed-violence-monitors_1/In-Focus-Armed-Violence-Monitor-on-Victims-of-Firearm-.pdf](#), sikurse citohet në studimin e pabotuar *Analiza mbi Mbështetjen e Viktimave të Dhunës me Armë në Ballkanin Perëndimor*, SEESAC, 2004

²⁵ SEESAC (2024). *In Focus Armed Violence Monitor – Victims of firearms incidents in the Western Balkans*.

https://www.seesac.org/f/docs/in-focus-armed-violence-monitors_1/In-Focus-Armed-Violence-Monitor-on-Victims-of-Firearm-.pdf

²⁶ Po aty.


²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty.



ishin më të prirur ndaj plagosjeve në kontekstin e dhunës ndërpersonale (34%) krahasuar me gratë (12%), ndërsa gratë përballëshin me kërcënime më shpesh (60%) sesa burrat (35%). Megjithatë, duhet vënë në dukje se ky lloj incidenti mund të raportohet shumë rrallë.²⁹ Mosmarrëveshjet në publik ishin lloji më i shpeshtë i incidenteve, me 345 viktima.³⁰

Grafiku 2: Numri i viktimave sipas llojit të incidenteve me armë zjarri në rajonin e Ballkanit Perëndimor:



Në kontekstin kriminal, u dokumentuan 293 viktima nga 218 incidente. Edhe në këtë rast, shumica ishin burra (74%). Megjithatë, në këtë kontekst vërehet një përqindje relativisht më e lartë e grave viktimave (26%) krahasuar me kontekstet e tjera. Bosnjë-Hercegovina raportoi numrin më të lartë të viktimave (88), pasuar nga Kosova (74) dhe Shqipëria (67). Ky kontekst karakterizohet gjithashtu nga një prevalencë e lartë e kërcënimeve, të cilat preknin 72% të viktimave, duke përfshirë një numër joproporcional grash. Shumica e këtyre incidenteve ndodhën në zonat urbane, duke prekur 220 viktima.³¹

Incidentet e dhunës në familje karakterizoheshin nga pabarazi të theksuara gjinore. Nga 97 incidente të tilla, u regjistruan 120 viktima, shumica e të cilave ishin gra (79 gra dhe 41 burra). Kosova (38 viktima) dhe Shqipëria (31 viktima) raportuan shifrat më të larta. Incidentet e dhunës në familje në vitin 2022 rezultuan në numrin më të lartë të vdekjeve në të gjitha kontekstet, me 18 gra dhe 10 burra të vrarë.³² Në këtë kontekst, gratë përbënin gjithashtu shumicën e viktimave të kërcënimit me armë zjarri (34 gra dhe 11 burra).

Incidentet e të shtënave në masë në Malin e Zi në vitin 2022 dhe në Serbi në vitin 2023 e përshkallëzuan më tej situatën e dhunës së armatosur në rajon. Në Malin e Zi, vrasjet në masë rezultuan në dhjetë vdekje, duke përfshirë dy djem, katër burra dhe katër gra, si dhe gjashtë të plagosur. Në Serbi, të shtënat në masë në një shkollë fillore në kryeqytet rezultuan në dhjetë viktima, duke përfshirë tetë

²⁹ Studimi për dhunën me bazë gjinore në BE (2024), që citohet në botimin e Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore - *Stepping up the response to victims of crime: FRA's findings on challenges and solutions*. Gjithashtu, SEESAC (2025): *Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje në Ballkanin Perëndimor: Tendencat kyç dhe shqetësimet kryesore* (studim i pabotuar)

³⁰ SEESAC (2022): *Small Arms Control – The Case for Gender Mainstreaming*. Dokument Informues për Rrjetin Global të Politikave të UNDP-së.


³¹ *Po aty*.

³² Është e rëndësishme të theksohet se në rastet e dhunës në familje, burrat nuk janë vrarë domosdoshmërisht nga partneret e tyre, por shpeshherë nga anëtarë të tjerë të familjes. Kjo theksohet në studimin e pabotuar të SEESAC të vitit 2025, *Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje në Ballkanin Perëndimor: Tendencat kyç dhe shqetësimet kryesore*.




vajza, një djalë dhe një burrë të rritur që punonte si rojë pranë shkollës, si dhe gjashtë persona të plagosur. Një tjetër rast i të shtënave në masë në një mjedis rural rezultoi në nëntë viktime, duke përfshirë tetë burra dhe një grua, dhe 13 persona mbetën të plagosur.

Grafiku 3: Përmbledhje rajonale e viktimave të ndara sipas gjinisë:



Grafiku 4: Raporti i vdekjeve dhe plagosjeve nga incidentet e të shtënave në masë të regjistruara gjatë periudhës 2022-2023:



Të shtënat e papërcaktuara rezultuan në 155 viktime, shumica prej të cilave ishin burra (94%). Shumica e viktimave në këto incidente u plagosën (61) ose nuk u plagosën (31), ndërsa marrëdhëniet midis viktimave dhe autorëve mbeten kryesisht të panjohura. Incidentet me motive të papërcaktuara përfshinin kryesisht armë dore dhe ndodhën në zonat urbane. Vendndodhja më e zakonshme ishin rrugët.³³

³³ Po aty.



Të dhënat e AVMP për vitin 2024 zbulojnë se burrat përfaqësonin 80% të të gjitha viktimave për të cilat specifikohet gjinia, duke përbërë shumicën dërrmuese të vdekjeve të shkaktuara nga armët e zjarrit. Burrat dominojnë edhe në rastet e plagosjeve, duke pasqyruar një ekspozim më të madh ndaj dëmtimeve të rënda fizike. Incidentet e lidhura me kërcënimet tregojnë një tjetër dinamikë: ndonëse janë burrat ata që kryesojnë për nga numri, gratë përballen me një përqindje disproporcionalisht të lartë të kërcënimeve me armë zjarri në raport me përfaqësimin e tyre të përgjithshëm.

Autorët janë kryesisht meshkuj (98%), përqindje e cila ka mbetur e pandryshuar me kalimin e kohës. Gratë përbëjnë 20% të viktimave, por vetëm 2% të autorëve. Shkalla e dhunës me armë zjarri ka vazhduar të mbetet e theksuar në mbarë rajonin: në vitin 2024, pati 113 persona të vrarë, 358 të plagosur dhe 397 të kërcënuar në incidente me armë zjarri. Tabela më poshtë jep një zberthim të detajuar³⁴:

Tabela 1: Incidentet me armë zjarri të regjistruara gjatë periudhës 2019-2024:


Gjinia	Vdekje	Vetëvrasje	Kërcënim	Plagosje	Nuk ka plagosje	Nuk ka	Totali
Burra	91	42	181	275	169	41	799
Gra	22	5	108	32	14	27	208
Nuk ka	0	0	108	51	22	14	195
Totali	113	47	397	358	205	82	1202

Gratë preken në mënyrë disproporcionale nga rastet e dhunës në familje. Megjithëse këto raste përfaqësojnë një pjesë relativisht të vogël të incidenteve të përgjithshme të lidhura me armët e zjarrit, vdekshmëria për gratë është dukshëm më e lartë. Një përmbledhje e të dhënave të AVMP për periudhën 2019 deri në 2024 tregon se armët e zjarrit kanë luajtur një rol masiv në dhunën nga partneri intim: 25% e grave të prekura nga dhuna në familje u vranë me armë zjarri, ndërsa 6% e grave u plagosën dhe gati gjysma u kërcënuan me armë zjarri. Dhjetë për qind janë përballur me situata ku është shkrepur një armë zjarri, por pa lëndime, ndërsa 27% janë përballur me situata ku ka qenë e pranishme një armë zjarri, por nuk është përdorur - një kujtesë tronditëse e kontrollit imponues.

Ndër autorët e dhunës me armë zjarri në kontekstin partneritetit intim, 97% ishin burra. 77% e rasteve përfshinin partnerë aktualë dhe 18% e tyre përfshinin ish-partnerë. Nga të gjithë autorët, 7% kishin një histori të dhunës në familje dhe 3% ishin pjesë e personelit ligjzbatues (12 oficerë, 10 burra dhe dy gra). Të gjitha rastet e regjistruara të vrasjeve-vetëvrasjeve janë kryer nga burrat kundër grave.

Të dhënat theksojnë nevojën urgjente për ndërhyrje gjithëpërfshirëse për të adresuar çështjen komplekse dhe shumëdimensionale të dhunës me armë dhe nevojën për shërbimet e duhura për viktimat.

³⁴ Sipas kategorizimit të AVMP, viktimë është çdo individ i prekur drejtpërdrejt nga një incident me armë zjarri, duke përfshirë ata që janë kërcënuar, plagosur ose vrarë si rezultat i përdorimit të një arme zjarri. Viktimat përfshijnë gjithashtu individë që kanë qenë të pranishëm në një vendngjarje kur është shkrepur arma e zjarrit, por që nuk janë plagosur. Gjithashtu, viktimat përfshijnë edhe individë që kanë qenë të pranishëm në vendngjarje kur është nxjerrë një armë zjarri, por nuk është përdorur në mënyrë aktive, pasi edhe thjesht prania e armës së zjarrit mund të ketë ndikim. Individët të cilëve u janë vjedhur armë zjarri konsiderohen gjithashtu si viktimë. Në këto raste, pasoja regjistrohet si "Nuk ka".

Grafiku 5: Viktimat e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje 2019-2024³⁵


Edhe pse juridiksionet e Ballkanit Perëndimor kanë bërë hapa të rëndësishëm për forcimin e kontrollit të AVL-ve dhe luftën kundër dhunës me armë, çështja e shërbimeve mbështetëse për viktimat ende nuk është adresuar në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Ka ende rrugë për t'u bërë për ofrimin e një mbështetjeje gjithëpërfshirëse për viktimat e dhunës me armë zjarri, dhe standardet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e viktimave nuk janë arritur ende.³⁶

Mbështetja e viktimave të incidenteve me armë zjarri nuk është thjesht një detyrim zyrtar, por një hap thelbësor drejt nxitjes së një shoqërie më të shëndetshme dhe më të përgjegjshme. Ofrimi i mbështetjes gjithëpërfshirëse i ndihmon viktimat të rikuperohen dhe të rindërtojnë jetën e tyre, duke kontribuar në mirëqenien e përgjithshme të komuniteteve dhe duke forcuar besimin në sistemin e drejtësisë dhe shtetin e së drejtës, e duke përmirësuar kështu sigurinë e përgjithshme të qytetarëve. Pavarësisht faktit se shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës me armë përbëjnë një komponent thelbësor për rritjen e sigurisë në komunitet, kjo temë është e paeksploruar jo vetëm në Ballkanin Perëndimor, por edhe në Evropë dhe në rang global. Duke pasur parasysh këtë, SEESAC bashkëpunoi me VDS për të kryer studimin e parë rajonal mbi shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës me armë zjarri.³⁷

³⁵ SEESAC (2025). *Incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje – Ballkani Perëndimor, 2019–2024*. Mund ta gjeni në: [IN_FOCUS_Domestic_violence_Western_Balkans_2019-2024_w.pdf](#)

³⁶ Sipas Krüsselmann dhe të tjerë, disponueshmëria e lartë e armëve të zjarrit është asociuar me norma më të larta të dhunës ndërpersonale në studime që janë fokusuar kryesisht në Shtetet e Bashkuara ose që kanë përdorur të dhëna ndërkombëtare të agreguara për të studiuar dhunën me armë zjarri. Ende mungojnë studimet empirike që përdorin ekskluzivisht të dhëna në nivel evropian (Krüsselmann K, Aarten P, Liem M (2021) *Firearms and violence in Europe—A systematic review*).

³⁷ VDS kreu një studim krahasues rajonal që përfshiu Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, me mbështetjen e Bankës Botërore; megjithatë, ai u përqendrua tek të drejtat e viktimave në përgjithësi: Ristanovic-Nikolic, V. (2018). *Mbështetja për viktimat në shtete të përzgjedhura të Ballkanit: Një perspektivë krahasuese* (Podrška žrtvama u izabranim državama Balkana: Komparativna perspektiva)



2

KUADRI NORMATIV
NDËRKOMBËTAR

2. KUADRI NORMATIV NDËRKOMBËTAR

Organet ndërkombëtare theksojnë rreziqet dhe efektet e rënda të incidenteve me armë zjarri. Veprimi i Koordinuar i OKB-së për Armët e Vogla (CASA) theksoi në vitin 2015 nevojën për mekanizma rregullatorë të përshtatshëm që marrin në konsideratë ndikimet unike të dhunës së armatosur mbi viktimat, familjet e tyre dhe komunitetet. Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut theksoi më tej ndikimin negativ të keqpërdorimit të armëve të zjarrit, duke përfshirë plagosjet jofatale, të një sërë të drejtash të njeriut në Raportin e tij të vitit 2016.³⁸ Komisioneri vuri në dukje specifikisht se dhuna me armë përbën shkelje të së drejtës së jetës, sigurisë dhe integritetit fizik, si dhe të të drejtave për liri dhe mbrojtje nga tortura.

Duke pasur parasysh natyrën unike dhe ashpërsinë e pasojave vdekjeprurëse dhe jovdekjeprurëse të veprimeve të lidhura me armët e zjarrit, pozicioni i viktimave të dhunës me armë është i ndryshëm nga ai i viktimave të dhunës me armë. Prandaj, shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës me armë zjarri duhet të jenë të përshtatura në mënyrë të posaçme me nevojat dhe dobësitë e tyre, duke mbuluar periudhën para, gjatë dhe për një kohëzgjatje të përshtatshme pas incidentit dhe procedurave penale përkatëse.

2.1. Kuadri i të drejtave të viktimave

Gjatë viteve 1980 dhe 1990, komuniteti ndërkombëtar bëri përpjekje të konsiderueshme për rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, duke përfshirë viktimat e incidenteve me armë zjarri. Miratimi i dokumenteve të shumta ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe ka vendosur standarde për trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave, duke njohur të drejtat e tyre dhe duke ofruar garanci për mbrojtjen e tyre. Parimet në lidhje me të drejtat e viktimave janë përcaktuar nga Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit, e miratuar në vitin 1985 (në vijim – Deklarata).³⁹

Deklarata i përkufizon “viktimat” si “persona që, individualisht ose kolektivisht, kanë pësuar dëm, duke përfshirë dëmtime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje

³⁸ *Të drejtat e njeriut dhe rregullimi i blerjes, zotërimit dhe përdorimit të armëve të zjarrit nga civilët* - Raport i Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. 15 prill 2016, A/HRC/32/21

³⁹ Rezoluta 40/34 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi Deklaratën e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit, e datës 29 nëntor 1985, e disponueshme në <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-basic-principles-justice-victims-crime-and-abuse>.



ekonomike ose cenim thelbësor të të drejtave të tyre themelore, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve që bien ndesh me ligjet penale që veprojnë brenda shteteve anëtare, duke përfshirë ato ligje që ndalojnë shpërdorimin kriminal të pushtetit.” (Neni A.1). Sipas kësaj Deklarate, një person mund të konsiderohet viktimë pavarësisht nëse autori është identifikuar, kapur, ndjekur penalisht ose dënuar dhe pavarësisht nga marrëdhënia familjare midis autorit dhe viktimës. Termi “viktimë” përfshin gjithashtu, sipas rastit, “rrethin e ngushtë familjar ose personat nën kujdestarinë e viktimës së drejtpërdrejtë dhe personat që kanë pësuar dëm gjatë ndërhyrjes për të ndihmuar viktimat në vështirësi ose për të parandaluar viktimizimin.” (Neni A.2).

Deklarata nuk ka fuqi detyruese ligjore dhe përfaqëson një sërë udhëzimesh dhe parimesh që synojnë të nxisin shtetet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të miratojnë masa për të siguruar akses në drejtësi dhe mbështetje për viktimat e krimit dhe shpërdorimit të pushtetit, pavarësisht nga mosha, gjinia, raca ose ndonjë karakteristikë tjetër personale e tyre. Ndonëse nuk ka fuqi detyruese ligjore, Deklarata ka ndikuar në formësimin e politikave dhe praktikave në lidhje me të drejtat dhe mbështetjen e viktimave.

Krahas Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit, ka dhe një sërë dokumentesh të tjera ndërkombëtare dhe rajonale që janë me rëndësi për mbrojtjen e viktimave të krimit, duke përfshirë viktimat e dhunës me armë zjarri.

Nga këndvështrimi i OKB-së, është e rëndësishme të përmendet koncepti i sigurisë së qytetarëve, i cili përqendrohet në garantimin e sigurisë së njerëzve nga krimi dhe dhuna, duke mbrojtur të drejtat e njeriut. Ai i jep përparësi parandalimit, mbrojtjes dhe mbështetjes së grupeve të cënueshme dhe viktimave të dhunës, duke përfshirë ato që janë prekur nga incidente me armë zjarri.⁴⁰

OKB-ja pranon se dhuna me armë, dhe veçanërisht ajo që përfshin armë zjarri, dëmton ndjeshëm sigurinë publike, zhvillimin dhe të drejtat e njeriut. Nismat për ta trajtuar këtë shpesh përfshijnë:

- Kontrollin e AVL-ve dhe rregullimin e armëve (p.sh. Programi i Veprimit i OKB-së për Parandalimin, Eliminimin dhe Luftën kundër Tregtisë së Paligjshme të AVL-ve, Traktati i Tregtisë së Armëve)
- Parandalimin e dhunës në komunitet
- Reformën ligjzbatuese
- Ndihmën dhe mbështetjen për viktimat.⁴¹

Instrumentet me fuqi detyruese ligjore

OKB:

- **Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)** (1979) dhe Rekomandimet e Përgjithshme përkatëse, që përfaqësojnë interpretime të autorizuara nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, dhe që qartësojnë

⁴⁰ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së: *Strengthening security sector reform*. Nju Jork, mars 2022 (Mund të gjendet në: 2022_280_english.pdf)

⁴¹ Në kapitullin e dytë jepet informacion i mëtejshëm mbi politikat dhe kuadrot ligjore të lidhura me AVL-të dhe përfshirjen e perspektivës së të drejtave të viktimave.

detyrimet e Shteteve Palë në bazë të Konventës – <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-elimination-all-forms-discrimination-against-women>

- **Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve** (1989) dhe Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin e Fëmijëve dhe Pornografinë e Fëmijëve, që mbrojnë të drejtat e të gjithë individëve nën moshën 18 vjeç – <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child> dhe <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/optional-protocol-convention-rights-child-sale-children-child>
- **Konventa kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar** dhe Protokollet përkatëse, duke përfshirë Protokollin për Parandalimin, Eliminimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve (2000) – <https://www.unodc.org/unodc/en/organized-crime/untoc.html> dhe https://www.unodc.org/documents/middleeastandnorthafrica//organised-crime/07-88185_Ebook.pdf

Këshilli i Evropës (KE):

- **Konventa për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore** (2005) – <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-display&treatyid=197>
- **Konventa e KE-së për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual - “Konventa Lanzarote”** (2007) – [CETS 201 - Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual](https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-display&treatyid=210)
- **Konventa për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje - “Konventa e Stambollit”** (2011) – <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-display&treatyid=210>

BE (me fuqi detyruese ligjore për shtetet anëtare të BE-së)⁴²:

- **Direktiva e Këshillit 2004/80/KE**, datë 29 prill 2004, “Për kompensimin e viktimave të krimit” [Directive - 2004/80 - EN - EUR-Lex](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32004L0080)
- **Direktiva 2011/93/BE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 2011, “Për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë, dhe për zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2004/68/ÇBD [Directive - 2011/93 - EN - EUR-Lex](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32011L0093)
- **Direktiva 2011/93/BE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 2011, “Për urdhrin evropian të mbrojtjes – rritja e mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat e krimit në të gjitha shtetet anëtare”. [Directive - 2011/99 - EN - EUR-Lex](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32011L0099)

⁴² Direktivat e BE-së janë instrumente me fuqi detyruese ligjore në BE, që i detyrojnë shtetet anëtare të arrijnë një rezultat të caktuar, ndonëse janë të lira ta zgjedhin vetë mënyrë sesi do ta arrijnë atë. Ato nuk kanë fuqi detyruese ligjore për juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, të cilat janë në faza të ndryshme të procesit të anëtarësimit në BE. Megjithatë, një pjesë e rëndësishme e procesit është harmonizimi i kuadrove ligjore me BE-në, që do të thotë se në të ardhmen, kur procesi i anëtarësimit të mbyllet me sukses, këto direktiva do të marrin fuqi detyruese ligjore.



- **Direktiva 2012/29/BE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012, “Për përcaktimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit” (Direktiva për të Drejtat e Viktimave)
[Directive - 2012/29 - EN - EUR-Lex](#)
- **Direktiva (BE) 2017/541** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 mars 2017, “Për luftën kundër terrorizmit dhe për zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/475/ÇBD dhe për ndryshimin e Vendimit të Këshillit 2005/671/ÇBD”
[Directive - 2017/541 - EN - EUR-Lex](#)
- **Direktiva (BE) 2024/1385** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 maj 2024, “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”
[Directive - EU - 2024/1385 - EN - EUR-Lex](#)
- **Direktiva (BE) 2024/1712** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 qershor 2024, “Për ndryshimin e Direktivës 2011/36/BE “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij”
[Directive - EU - 2024/1712 - EN - EUR-Lex](#)

Instrumentet që nuk kanë fuqi detyruese ligjore (por kanë ndikim të rëndësishëm normativ)

Sikurse u përmend edhe më parë, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit është me rëndësi thelbësore dhe ka ndikim të madh normativ, megjithëse nuk është ligjërish e detyrueshme për shtetet palë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Instrumente të tjera ligjore me rëndësi janë:

KE⁴³:

- Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të KE-së nr. R (85) 11 për Pozitën e Viktimave në të Drejtën Penale dhe Procedurën Penale (1985) – <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804dcca>
- Rekomandimi i Komitetit të Ministrave Nr. R (87) 21 për Ndihmën ndaj Viktimave dhe Parandalimin e Viktimizimit (1987) – <https://rm.coe.int/16805afa5c>
- Rekomandimi nr. R (97) 13 për Intimidimin e Dëshmitarëve dhe të Drejtën e Mbrojtjes (1997) – <https://rm.coe.int/1680a6dafc>
- Rekomandimi i Komitetit të Ministrave Nr. R (2006) 8 për Ndihmën ndaj Viktimave të Krimit (2006) – [Rec\(2006\)8](#)

BE:

- Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave (2020-2025), miratuar nga Komisioni Evropian më 24 qershor 2020⁴⁴ – https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/criminal-justice/protecting-victims-rights/eu-strategy-victims-rights-2020-2025_en

⁴³ Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të KiE-së janë instrumente ligjore jodetyruese. Ato japin udhëzime dhe i nxisin juridiksionet të miratojnë politika ose praktika të caktuara, por nuk përbëjnë në vetvete traktate me fuqi detyruese ligjore.

⁴⁴ Kjo strategji e BE-së është një dokument politik që përshkruan qëllimet dhe veprimet. Ndonëse ajo përcakton kuadrin për nismat e ardhshme legjislative (si direktivat ose rregulloret, të cilat kanë fuqi detyruese), vetë dokumenti i strategjisë nuk ka fuqi detyruese ligjore për shtetet anëtare të BE-së.

2.2. Përshkrimi i të drejtave të viktimave siç përshkruhet në Instrumentet ligjore kryesore rajonale

Konventa e Stambollit është një instrument rajonal veçanërisht i rëndësishëm me fuqi ligjore detyruese për Ballkanin Perëndimor, në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, ku ka shpeshherë keqpërdorim të armëve të zjarrit. Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut e kanë ratifikuar Konventën pa rezerva, ndërsa Serbia e ka ratifikuar atë me dy rezerva. Kosova, edhe pse nuk është anëtare e KE-së, i ka dhënë Konventës fuqi të drejtpërdrejtë përmes një ndryshimi kushtetues.⁴⁵

Ndonëse Konventa e Stambollit nuk trajton specifikisht viktimat e dhunës me armë, neni 51 i detyron shtetet palë të vlerësojnë rrezikun e vdekshmërisë, duke marrë parasysh nëse autori zotëron ose ka akses në armë zjarri, gjë që rrit rrezikun për vrasje. Ai parashikon planifikimin e sigurisë për viktimat dhe sigurinë dhe mbështetjen e koordinuar.

Krahas trajtimit të dhunës në familje, Konventa e Stambollit përfshin një gamë të gjerë veprash penale të rënda, duke përfshirë martesën e detyruar, përndjekjen, dhunën psikologjike, dhunën fizike, dhunën seksuale, si përdhunimi, gjymtimi i organeve gjenitale femërore, aborti i detyruar, sterilizimi i detyruar, ngacmimi seksual dhe krimet e kryera në emër të “nderit”. Të gjitha këto mund të përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit.

Termi “viktimë” në Konventë i referohet çdo personi fizik që është subjekt i dhunës ndaj grave ose dhunës në familje.

Ndërkohë që viktimat e dhunës ndaj grave mund të jenë vetëm gratë dhe vajzat, viktimat e dhunës në familje mund të përfshijnë burra dhe gra, si dhe fëmijë. Sipas Konventës së Stambollit, viktimat kanë të drejtë të kenë akses në shërbime të specializuara, si dhe në shërbime më të përgjithshme mbështetëse, për të përmbushur nevojat e tyre për rikuperim. Këto masa të përgjithshme duhet të përfshijnë, sipas nevojës, shërbime të tilla si këshillimi ligjor dhe psikologjik, ndihma financiare, strehimi, arsimi, kujdesi shëndetësor, shërbimet sociale, trajnimi dhe ndihma për gjetjen e punës (neni 20). Shërbimet mbështetëse të specializuara kanë të bëjnë me strehat, linjat telefonike, si dhe qendrat e referimit për rastet e përdhunimit ose të dhunës seksuale. Shërbimet e specializuara duhet të jenë të aksesueshme për të gjitha gratë viktimat të dhunës dhe fëmijët e tyre. Dëshmitarëve të mitur u jepet mbrojtje dhe mbështetje e veçantë, siç është këshillimi psikosocial i përshtatshëm për moshën (neni 26).

Neni 56 i Konventës së Stambollit i detyron shtetet palë të marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të ndihmuar dhe/ose mbështetur viktimat në të gjitha fazat e procedurave hetimore

⁴⁵ Shqipëria e ratifikoi Konventën e Stambollit në vitin 2013, Bosnjë-Hercegovina në vitin 2013, Mali i Zi në vitin 2014 dhe Maqedonia e Veriut në vitin 2018. Serbia e ratifikoi Konventën e Stambollit në vitin 2013, me rezerva për nenin 30, paragrafi 2 (në lidhje me kompensimin e viktimave) dhe nenin 44, paragrafi 1, germa “e” dhe paragrafi 4 (në lidhje me juridiksionin për të zbatuar masat kur vepra kryhet nga një person jashtë Serbisë). Kosova nuk e ka ratifikuar Konventën e Stambollit, pasi nuk është anëtare e KE-së dhe anëtarësia është parakusht për ratifikimin. Megjithatë, Asambleja Kombëtare e Kosovës miratoi një ndryshim të Kushtetutës së saj në vitin 2020, duke i dhënë fuqi të drejtpërdrejtë Konventës së Stambollit. Kjo do të thotë se konventa është e përfshirë drejtpërdrejt në kuadrin ligjor të Kosovës dhe ka përparësi në rastet e konfliktit me ligjin e brendshëm.



dhe gjyqësore, në veçanti duke siguruar masa për mbrojtjen e tyre, si dhe mbrojtjen e familjeve të tyre dhe dëshmitarëve, nga intimidimi, hakmarrja dhe viktimizimi i përsëritur. Këto masa përfshijnë ofrimin e shërbimeve të përshtatshme mbështetëse për viktimat, për të siguruar që të drejtat dhe interesat e tyre të përfaqësohen dhe të merren në konsideratë siç duhet.

Konventa e KE-së për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (neni 12) dhe Konventa e KE-së për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual (neni 14) i detyrojnë shtetet anëtare të ofrojnë ndihmë për rimëkëmbjen fizike, psikologjike dhe sociale të viktimave. Megjithatë, asnjëra nga konventat nuk trajton në mënyrë të posaçme viktimat e dhunës me armë dhe krimin.

Ndonëse instrumentet e ratifikuara të KE-së kanë fuqi detyruese ligjore për juridiksionet/subjektet përgjegjëse, direktivat e BE-së nuk e kanë një fuqi të tillë. Megjithatë, ato konsiderohen mjaft të rëndësishme për shkak të aspiratave të të gjitha juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor për t'u anëtarësuar në BE dhe nevojës për të harmonizuar kuadrot e tyre ligjore me legjislacionin e BE-së si pjesë e procesit të anëtarësimit.

Direktiva për të drejtat e viktimave (Direktiva e BE-së 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012) shënon një hap të rëndësishëm në përcaktimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit në mbarë BE-në. Kjo direktivë zbatohet për të gjitha viktimat e krimit pa diskriminim. Ajo vlen për të gjitha procedurat penale që zhvillohen në një shtet anëtar të BE-së, pavarësisht nga koha dhe vendndodhja e krimit.⁴⁶ Qëllimi i Direktivës për të Drejtat e Viktimave është të sigurojë që viktimat e krimit të marrin informacionin, mbështetjen dhe mbrojtjen e nevojshme, duke lehtësuar gjithashtu pjesëmarrjen e tyre aktive në procedurat penale. Ajo thekson një qasje të individualizuar për dhënien e informacioneve dhe shërbimeve mbështetëse, duke marrë parasysh nevojat specifike të viktimës, situatën personale dhe ashpërsinë e veprës penale.

Elementet kryesore të Direktivës për të Drejtat e Viktimave janë:

Njohja dhe respekti: Viktimat duhet të njihen dhe të trajtohen me respekt dhe dinjitet.

Mbrojtja: Duhet të merren masa për të mbrojtur viktimat nga intimidimi, hakmarrja dhe dëmtimi i mëtejshëm gjatë hetimeve penale dhe procedurave gjyqësore.

Mbështetja: Viktimat duhet të marrin ndihmë të menjëhershme dhe afatgjatë fizike, psikologjike dhe praktike, siç është përkthimi, për të siguruar që viktima të arrijë të kuptojë dhe të kuptohet.

Aksesi në drejtësi: Viktimat duhet të informohen për të drejtat e tyre dhe të jenë në gjendje të marrin pjesë në procedurat penale.

Kompensimi dhe restaurimi: Viktimat duhet të kenë akses në kompensim financiar dhe në opsionet e drejtësisë restauruese.

⁴⁶ Në vitin 2002, BE-ja miratoi një Vendim Kuadër që përcaktonte të drejtat minimale për viktimat e krimit – një instrument me fuqi detyruese ligjore që shënoi përparim krahasuar me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit. Megjithatë, vlerësimet e kryera në vitin 2004 dhe 2009 nxorën në pah se asnjë shtet anëtar nuk i kishte respektuar plotësisht dispozitat e tij. Për rrjedhojë, Vendimi Kuadër u zëvendësua në vitin 2012 nga Direktiva për të Drejtat e Viktimave, e cila parashikonte standarde më solide dhe gjithëpërfshirëse, duke ofruar mbrojtje më të forta ligjore për viktimat në mbarë BE-në (parafrazim nga *Victims' protection: International law, national legislations and practice – Book of abstracts* nga Konferenca e Pestë Vjetore e Shoqatës së Viktimologjisë së Serbisë, nëntor 2014. Direktiva për të drejtat e viktimave zbatohet për të gjitha shtetet anëtare të BE-së, me përjashtim të Danimarkës. Danimarka ka një përjashtim nga fusha të caktuara të legjislacionit të BE-së për drejtësinë dhe çështjet e brendshme, duke përfshirë edhe këtë direktivë.



Direktiva kërkon gjithashtu që shtetet anëtare të BE-së të ofrojnë trajnime të përshtatshme për personat përgjegjës që ndërveprojnë me viktimat.

Direktiva për të drejtat e viktimave njeh si viktimat e drejtpërdrejta, ashtu edhe ato jo të drejtpërdrejta të krimit.

Viktimë e drejtpërdrejtë është “një person fizik që ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmin fizik, psikologjik ose emocional, ose humbjen ekonomike që është shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale”. Viktimat jo të drejtpërdrejta janë “anëtarët e familjes së një personi, vdekja e të cilit është shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale, dhe që kanë pësuar dëm si rezultat i vdekjes së atij personi”. “Anëtarët e familjes” janë bashkëshorti/ja, personi që bashkëjeton me viktimën në një marrëdhënie intime të përkushtuar, në një shtëpi të përbashkët dhe në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, të afërmit në linjë të drejtpërdrejtë, vëllezërit e motrat dhe personat nën kujdestarinë e viktimës.

Të gjitha shërbimet e mbështetjes së viktimave duhet të jenë konfidenciale, të përshtatshme, pa pagesë dhe të disponueshme për viktimat para, gjatë dhe për një periudhë të caktuar pas procedurave penale. (Neni 8). Viktimat duhet të kenë akses në këto shërbime pavarësisht nëse e kanë raportuar zyrtarisht krimin, d.m.th. pavarësisht nga statusi ligjor i çështjes specifike. Përveç kësaj, shtetet anëtare të BE-së duhet të sigurojnë që viktimat të mbështeten në përputhje me të drejtën e tyre për trajtim të barabartë, që garantohet nga neni 20 i Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së.⁴⁷

Sipas Direktivës për të Drejtat e Viktimave, të drejtat e viktimave ndahen në tre kategori kryesore:

1. E drejta për informacion dhe mbështetje⁴⁸,
2. E drejta për të marrë pjesë në procedurat penale, dhe
3. E drejta për mbrojtje.

Ky akt ligjor vë një theks të veçantë tek e drejtën e viktimave për informacion, e cila është thelbësore për ushtrimin e të drejtave të tjera. Neni 4 parashikon se viktimat kanë të drejtë të marrin informacion nga pika e parë e kontaktit me një autoritet kompetent.⁴⁹

Direktiva për të Drejtat e Viktimave parashikon se shtetet anëtare duhet të marrin masa për të siguruar që viktimat të kenë në dispozicion forma të specializuara mbështetjeje. Këto shërbime mund të ofrohen nga subjekte autonome ose të integrohen brenda shërbimeve më të gjera të mbështetjes së viktimave. Si shërbimet mbështetëse të përgjithshme, ashtu edhe ato të specializuara mund të funksionojnë si shërbime publike ose nëpërmjet OShC-ve, duke përfshirë kontributet e punonjësve dhe vullnetarëve.

⁴⁷ Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni Evropian (2012), Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, Gazeta Zyrtare 2012 C 326 (gjendet në: [Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian](#))

⁴⁸ Për viktimat e incidenteve me armë zjarri që janë plagosur, ndihma e menjëhershme mjekësore lidhet me menaxhimin e plagës, veçanërisht për shkak se plagët me armë zjarri paraqesin shpeshherë rrezik për jetën.

⁴⁹ Përveç këtij informacioni në lidhje me shërbimet mbështetëse, nga kontakti i tyre i parë me një autoritet kompetent, viktimat kanë të drejtë të informohen për të drejtat e tyre në lidhje me procedurat penale ose procedurat e tjera gjyqësore, të drejtën për një përkthyes, të drejtat për kompensim, disponueshmërinë e ndihmës juridike, programet ekzistuese restauruese, mundësitë për paraqitjen e ankesave nëse të drejtat e tyre nuk respektohen, masat e veçanta të mbrojtjes nëse personi bëhet viktimë në një shtet tjetër anëtar të BE-së dhe kostot e procedurave ligjore.



Neni 9 përcakton dispozitat në lidhje me mbështetjen minimale që shërbimet për viktimat duhet t'u ofrojnë viktimave. Këto dispozita përfshijnë:

- Informacion mbi të drejtat e viktimave, duke përfshirë detaje në lidhje me shërbimet mbështetëse të specializuara
- Informacion në lidhje me shërbimet mbështetëse të specializuara përkatëse ose referim të drejtpërdrejtë tek ato
- Mbështetje emocionale dhe ndihmë psikologjike
- Këshillim në lidhje me çështjet financiare dhe çështje të tjera praktike
- Këshillim në lidhje me rreziqet dhe parandalimin e viktimizimit dytësor, riviktimizimit, intimidimit dhe hakmarrjes.

Sipas nenit 9.2, shërbimet për mbështetjen e viktimave duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë nevojave të posaçme të viktimave që kanë pësuar dëme të konsiderueshme për shkak të ashpërsisë së krimit. Neni 9.3 specifikon më tej se shërbimet mbështetëse të specializuara duhet të përfshijnë të paktën streha ose akomodime të tjera të sigurta për viktimat që përballen me një rrezik të menjëhershëm të riviktimizimit, viktimizimit dytësor, intimidimit ose hakmarrjes. Gjithashtu, këto shërbime duhet të ofrojnë mbështetje të personalizuar, duke përfshirë mbështetje për traumat dhe këshillim për viktimat me nevoja të posaçme si pasojë e natyrës së krimit ose e marrëdhënies së tyre me autorin e krimit, siç janë viktimat e dhunës seksuale, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës nga partneri intim.

Së fundi, Direktiva për të Drejtat e Viktimave i udhëzon shtetet anëtare të BE-së të miratojnë procedura për kufizimin e numrit të anëtarëve të familjes që mund të përfitojnë nga të drejtat e përcaktuara në këtë direktivë, duke marrë parasysh rrethanat individuale të secilit rast. Ajo kërkon gjithashtu që të përcaktohet se cilët anëtarë të familjes duhet të kenë përparësi në ushtrimin e këtyre të drejtave.⁵⁰

Edhe pse kuadri i BE-së për mbrojtjen e të drejtave të viktimave konsiderohet i fortë, shoqëria civile vazhdon të advokojë për përmirësime dhe rishikime të mëtejshme të kuadrit ligjor ekzistues. Sipas një raporti të vitit 2023 të hartuar për Victim Support Europe, "ka ende mangësi të konsiderueshme në zbatimin e plotë dhe efektiv të Direktivës për të Drejtat e Viktimave". Shumë shtete anëtare ende nuk i përmbushin detyrimet e tyre. Viktimat përballen shpeshherë me sfida serioze: ato nuk marrin informacion në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme dhe shërbimet e duhura të mbështetjes shpesh nuk janë të disponueshme. Për rrjedhojë, shumë viktimat nuk marrin ndihmën që u nevojitet për t'u rikuperuar dhe vazhdojnë të jenë të cenueshme nga riviktimizimi dhe të mos gëzojnë mbrojtje të përshtatshme nga dëmtimi i mëtejshëm gjatë ndërveprimeve të tyre me sistemin e drejtësisë.⁵¹

Duke pasur parasysh nevojën për të monitoruar dhe përmirësuar më tej sistemin për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, BE-ja ka miratuar **Strategjinë për të Drejtat e Viktimave** për periudhën 2020-2025, e cila përcakton një sërë veprimesh për Komisionin, shtetet anëtare të BE-së dhe shoqërinë civile.⁵²

⁵⁰ Duke pasur parasysh se disa viktimat të krimit janë më të cenueshme se të tjerat për shkak të karakteristikave të tyre personale, natyrës së krimit të kryer ose rrethanave të tyre, BE-ja ka miratuar instrumente që u përgjigjen nevojave të posaçme të viktimave: viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (Direktiva kundër trafikimit), viktimat e shfrytëzimit seksual të fëmijëve (Direktiva kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve) dhe viktimat e terrorizmit (Direktiva kundër terrorizmit).

⁵¹ L. Altan, L.Meindre Chautrand, A. Blondé, S. Baudouin-Naneix. Victim Support Europe – VSE (2023). *Victims of Crime – Model Provisions Paper: VSE's vision for a revised victims' rights directive*.

⁵² Komisioni Evropian. Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave 2020-2025 Bruksel, 24 qershor 2020, COM (2020) 258 përfundimtar (gjendet në: eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0258)



Strategjia bazohet në pesë prioritete:

1. Komunikimi efektiv me viktimat dhe një mjedis i sigurt për viktimat për të raportuar krimin
2. Përmirësimi i mbështetjes dhe mbrojtjes për viktimat më të cenueshme
3. Lehtësimi i aksesit të viktimave në kompensim
4. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit midis të gjithë aktorëve përkatës, dhe
5. Forcimi i dimensionit ndërkombëtar të të drejtave të viktimave.

Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave thekson se vështirësitë e viktimave në lidhje me aksesin në drejtësi janë kryesisht për shkak të mungesës së informacionit, mbështetjes së pamjaftueshme dhe mbrojtjes së pamjaftueshme. Ato janë shpeshherë të ekspozuara ndaj viktimizimit dytësor gjatë procedurave penale dhe kur kërkojnë kompensim.⁵³ Prandaj, Strategjia thekson se duhet t'u kushtohet një vëmendje e veçantë viktimave me nevoja të veçanta të mbrojtjes nga rreziqet e viktimizimit dytësor ose të përsëritur, intimidimit dhe hakmarrjes, siç janë viktimat e dhunës me bazë gjinore, viktimat në moshë të mitur, viktimat me aftësi të kufizuara, viktimat e moshuara, viktimat e krimeve të urrejtjes, viktimat e terrorizmit dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.⁵⁴

Bazuar në instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe rajonale, **të drejtat themelore të viktimave të krimit, duke përfshirë viktimat e dhunës me armë**, duhet të përfshijnë:

- Të drejtën për t'u njohur dhe pranuar si viktimë
- Të drejtën për akses në drejtësi dhe trajtim të drejtë
- Të drejtën për t'u informuar për të drejtat e tyre, statusin në procedura penale ose procedura të tjera gjyqësore, si dhe ndihmën dhe mbështetjen në dispozicion
- Të drejtën për t'u dëgjuar në fazat e dhura të procedurës penale, duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e tyre dhe duke mbrojtur integritetin e tyre fizik dhe psikologjik
- Të drejtën për ndihmë dhe mbështetje para, gjatë dhe pas procedurave penale, pavarësisht nga procedura penale ose procedura të tjera gjyqësore, duke përfshirë marrjen e informacionit, mbështetjes emocionale dhe referimeve të shërbimit të përgjithshme dhe të specializuara për viktimat
- Të drejtën për veprim urgjent, duke shmangur vonesat e panevojshme në procedura

⁵³ Shihni J. Milquet (2019). *Strengthening Victims' Rights: From Compensation to Reparation – For a new EU Victims' rights strategy 2020-2025*. Report of the Special Adviser J. Milquet to the President of the European Commission.

⁵⁴ Veçanërisht, vlerësimi i vitit 2022 për Direktivën për të Drejtat e Viktimave nuk përfshin një shqyrtim gjithëpërfshirës të zbatimit të direktivës nga Shtetet Anëtare nga perspektiva e viktimave të dhunës me armë. Sipas vlerësimit (citim fjalë për fjalë), "Shtetet anëtare të BE-së duhet ta transpozoinin direktivën në sistemet e tyre ligjore kombëtare brenda datës 16 nëntor 2015.... Në datën e botimit të raportit të Komisionit për zbatimin e Direktivës për të Drejtat e Viktimave, shumica e shteteve anëtare nuk e kishin transpozuar plotësisht direktivën. Për shkak të progresit të bërë që nga miratimi i raportit, Komisioni ka mbyllur në mënyrë progresive pothuajse të gjitha procedurat e shkeljeve për transpozimin jo të plotë të direktivës. Megjithatë, një çështje kyç që rezulton nga analiza e raportit për zbatimin e Direktivës për të Drejtat e Viktimave është interpretimi i disa kushteve të caktuara dhe mungesa e kritereve mjaftueshëm të qarta për standardet minimale. Megjithëse janë përcaktuar qartë në Direktivë, përkufizimet e "viktimës" dhe "anëtarit të familjes" janë interpretuar ndryshe në një sërë shtetesh anëtare... Kjo rezulton në interpretime shumë të ndryshme të asaj që përbën informacion, mbështetje dhe akses "cilësor" në shtetet anëtare. Studimi vlerësues nxori në pah mungesën e kritereve si një problem për nenin 3 (të kuptojnë dhe të kuptohen), 4 (marrja e informacionit), 8 (aksesi në shërbimet mbështetëse) dhe 9 (shërbimet e mbështetjes së viktimave)". (mund të gjendet në: [swd_2022_179_evaluation_rep_en.pdf](#))



- Të drejtën për mbrojtje nga ngacmimi, intimidimi, kërcënimet, sulmet dhe riviktimizimi ose viktimizimi dytësor
- Të drejtën për dëmshpërblim.

Shembull i mbështetjes së personalizuar për viktimat e dhunës me armë zjarri bazuar në Qasjen për të Drejtat e Viktimave

Tabela 2: Mbështetja e personalizuar për viktimat - shembuj

Lloji i mbështetjes (vini re se çfarëdo lloj mbështetjeje që ofrohet, duhet të ofrohet në mënyrë të respektueshme, të ndjeshme dhe jodiskriminuese)	Përshkrimi i veprimit (vini re se lista e veprimeve nuk është shteruese dhe duhet të përcaktohet rast pas rasti)
Faza e krizës dhe mbështetja e menjëhershme (ditët/javët e para)	
Ndihma e menjëhershme	<ul style="list-style-type: none"> - Ndihma e parë mjekësore dhe psikologjike në vendngjarje ose në spital (nëse ofrohet në vendngjarje, prioritet i jepet vlerësimit të sulmeve të mëtejshme dhe shmangies së rrezikut për ata që ndihmojnë viktimat dhe për vetë viktimat) - Vlerësimi i shpejtë i nevojave individuale (natyra dhe rrethanat e krimit, karakteristikat personale të viktimës, marrëdhënia me autorin) - Masat emergjente të sigurisë (p.sh. urdhrat e mbrojtjes, strehimi i sigurt) - Informacion i qartë dhe i kuptueshëm në lidhje me të drejtat dhe shërbimet (shërbimet e përgjithshme dhe të specializuara)
Rikuperimi gjithëpërfshirës i vazhdueshëm (javë/muaj)	
Mbështetje psikologjike dhe mjekësore	<ul style="list-style-type: none"> - Terapi e fokusuar tek traumat - Rehabilitim fizik dhe menaxhim i dhimbjes (në rast lëndimi fizik) - Mbështetje për shëndetin mendor të viktimave dhe familjeve të tyre
Ndihmë praktike dhe financiare	<ul style="list-style-type: none"> - Ndihmë me dokumentacionin, sigurimet dhe përfitimet sociale - Ndihmë financiare emergjente dhe mbështetje afatgjatë për kompensimin - Ndihmë me detyrat e përditshme dhe transportin, sipas nevojës
Ndihmë ligjore	<ul style="list-style-type: none"> - Ndihmë juridike dhe shoqërim gjatë procedurave penale - Mbrojtje e viktimave gjatë procedurave gjyqësore (p.sh. mundësi- mi i dëshmimeve me video, mbrojtja e privatësisë) - Sigurimi i të drejtës së viktimës për t'u informuar, për t'u dëgjuar dhe për rishikim të vendimeve



Mbështetje nga grupi	- Hyrje në një grup mbështetës për viktimat e krimeve të dhunshme, për t'u njohur me persona të tjerë që e kuptojnë përvojën e viktimës
Koordinim dhe mbështetje e posaçme	- Menaxhim i dedikuar i rasteve për koordinimin e shërbimeve - Mbështetje e përshtatshme për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara ose viktimat e marxhinalizuara për shkak të disa karakteristikave të tjera personale
Qëndrueshmëri dhe fuqizim afatgjatë (muaj/vite)	
Mbështetje e vazhdueshme për shëndetin mendor	Akses i vazhdueshëm në terapi sipas nevojës për mirëqenie të qëndrueshme
Riintegrim në komunitet	Mbështetje për riangazhimin gradual në jetën publike, mundësisht përmes ekspozimeve nën udhëheqje ose aktiviteteve për ndërtimin e besimit
Mundësi për angazhim personal dhe advokim	Ofrim i mundësive për të marrë pjesë në advokimin për viktimat ose aktivitete të parandalimit të dhunës në komunitet nëse viktima është e hapur/e gatshme ta bëjë këtë.

2.3. Kuadri i kontrollit të AVL-ve

Kuadri i kontrollit të AVL-ve u referohet në mënyrë të kufizuar viktimave të dhunës me armë.

Protokolli i OKB-së kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve (Protokolli për armët e zjarrit)⁵⁵ u siguron juridiksioneve një kuadër politik për të kontrolluar dhe rregulluar flukset e armëve, për të parandaluar devijimin e tyre në tregun e armëve të jashtëligjshme dhe për të lehtësuar hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të lidhura, pa penguar transferimet e ligjshme. Megjithatë, ai nuk trajton çështje që lidhen me viktimat e dhunës me armë.

Programi i Veprimit i OKB-së për Parandalimin, Eliminimin dhe Luftën kundër Tregtisë së Paligjshme të AVL-ve (PV),⁵⁶ një kuadër i dakordësuar globalisht për aktivitetet për kontrollin e pasojave negative të AVL-ve, përmend çështjen e viktimave në Preambulën e tij. Kjo referencë trajton rëndësinë e PV-së duke njohur pasojat shkatërruese të tregtisë së paligjshme të AVL-ve mbi viktimat e konflikteve të armatosura, duke përfshirë fëmijët.

Dokumenti Rezultues i Konferencës së Katërt për Rishikimin e Progresit të bërë me Zbatimin e PV-së dhe Instrumentit të saj Ndërkombëtar të Gjurmimit (ITI)⁵⁷ nga qershori 2024⁵⁸ përshkruan

⁵⁵ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 55/255 (mund të gjendet në: [0141176e.doc](#))

⁵⁶ Programi i Veprimit i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Eliminimin dhe Luftën kundër Tregtisë së Paligjshme të Armëve të Vogla dhe të Lehta në të gjitha aspektet, Dokument i OKB-së A/CONF.192/15 (mund të gjendet në: [unpoa-prog-of-action.pdf](#))

⁵⁷ Në vitin 2005, shtetet anëtare të OKB-së miratuan Instrumentin Ndërkombëtar për t'u mundësuar shteteve identifikimin dhe gjurmimin në kohë dhe në mënyrë të besueshme të Armëve të Vogla dhe të Lehta të Paligjshme (Instrumenti Ndërkombëtar i Gjurmimit – ITI), i cili u kërkon juridiksioneve të sigurojnë që armët të jenë të pajisura me shënimet e duhura dhe që të ruhen të dhënat përkatëse. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme A/RES/60/81.

⁵⁸ Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Raporti i Konferencës së katërt të OKB-së për rishikimin e progresit të bërë për zbatimin e Programit të Veprimit për Parandalimin, Eliminimin dhe Luftën kundër Tregtisë së Paligjshme të Armëve të Vogla dhe të Lehta në të gjitha aspektet e saj, 5 korrik 2024, A/CONF.192/2024/RC/3



se zbatimi i plotë dhe efektiv i PV-së dhe ITI-t “përfiton nga sigurimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe perspektivave të viktimave dhe të mbijetuarve të prekur nga dhuna me armë dhe AVL-të e paligjshme dhe organizatave të tyre përfaqësuese” (paragrafi 42). Dokumenti Rezultues i Konferencës njih lidhjet midis dhunës me armë të lidhur me AVL-të e paligjshme dhe shëndetit të grave, burrave, vajzave dhe djemve, që përbëjnë shqetësim për shëndetin publik. Adresimi i ndikimeve të dhunës me armë zjarri në shëndetin mendor kërkon strategji dhe programe që synojnë parandalimin, duke siguruar gjithashtu rrjete gjithëpërfshirëse të sigurisë sociale për viktimat (paragrafi 134). Prandaj, Dokumenti Rezultues bën thirrje për krijimin ose forcimin e programeve të ndihmës për viktimat, të mbijetuarit dhe personat e tjerë të prekur nga dhuna e armatosur në kontekstin e tregtisë së paligjshme të AVL-ve (paragrafi 206).

Strategjia e BE-së kundër Armëve të Paligjshme të Zjarrit, Armëve të Vogla dhe të Lehta dhe Municioneve të tyre (2018) bazohet në PV-në e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, ai nuk adreson nevojën për mbështetje për viktimat e dhunës me armë.⁵⁹


I tillë është edhe rasti i **Udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e jashtëligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e AVL-ve dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor brenda vitit 2024** (Udhërrëfyesi).⁶⁰ Juridiksionet e Ballkanit Perëndimor angazhohen ndaj objektivave të Udhërrëfyesit për të reduktuar në mënyrë të konsiderueshme ofertën, kërkesën dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit, informimit dhe advokimit. Udhërrëfyesi njih nivelin e lartë të keqpërdorimit të armëve të zjarrit, veçanërisht në kontekstin e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore (Objektivi 4). Gjithashtu, Udhërrëfyesi synon të rrisë ndërgjegjësimin te meshkujt e rinj lidhur me rreziqet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, pasi ata përfaqësojnë shumicën e autorëve dhe të viktimave të incidenteve me armë.

Udhërrëfyesi 2025-2030 është miratuar në Forumin Ministror midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme në tetor të vitit 2024. Dokumenti i sapomiruar thekson, te përshkrimi i situatës aktuale lidhur me Objektivin #4, se “niveli i ndërgjegjësimit për mbështetjen e nevojshme për viktimat e dhunës me armë është i kufizuar”, duke iu referuar kështu çështjes së mbështetjes për viktimat e dhunës me armë.⁶¹

⁵⁹ Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian për Miratimin e një Strategjie të BE-së kundër Armëve të Paligjshme të Zjarrit, Armëve të Vogla dhe të Lehta dhe Municioneve të tyre, Nr. 13581/18, Bruksel, 19 nëntor 2018, të disponueshme në: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-13581-2018-INIT/en/pdf>

⁶⁰ Mund ta gjeni në: <https://www.seesac.org/f/docs/publications-salw-control-roadmap/Regional-Roadmap-for-a-sustainable-solution-to-the.pdf>

⁶¹ Mund ta gjeni në: [Roadmap ENG](#)



3

PANORAMA E PËRGJITHSHME E
KUADROVE LIGJORE NË JURIDIKSIONET
E BALLKANIT PERËNDIMOR

3. PANORAMA E PËRGJITHSHME E KUADROVE LIGJORE NË JURIDIKSIONET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Në të gjashta juridiksionet e shqyrtuara të Ballkanit Perëndimor - Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia - përkufizimi ligjor i “viktimës” paraqet si ngjashmëri të përbashkëta, ashtu edhe dallime që pasqyrojnë specifikat e secilit juridiksion. Megjithëse koncepti i përgjithshëm lidhet me dëmin e shkaktuar si rezultat i një vepre penale, ndryshimet në terminologji, në fushën e zbatimit dhe në zbatim tregojnë për një larmi qasjesh brenda rajonit.

3.1. Përkufizimi ligjor i termit “viktimë” - Karakteristikat e përbashkëta

Një element i përbashkët i të gjitha juridiksioneve është se viktimë konsiderohet çdo person që ka pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i një vepre penale. Ky dëm ka një kuptim të gjerë dhe mund të jetë fizik, psikologjik, emocional dhe ekonomik. Në disa juridiksione, përdoret ende termi historik “palë e dëmtuar” në vend të termit “viktimë”. Edhe pse disa juridiksione po kalojnë drejt përdorimit të termit “viktimë”, termi “palë e dëmtuar” ka qenë historikisht termi kryesor i përdorur dhe përkufizohet zakonisht si personi të cilit i janë cenuar ose rrezikuar të drejtat personale apo pasurore nga vepra penale.

Vërehet një zhvillim i qëndrueshëm në lidhje me artikullimin specifik të termit “viktimë” në legjisllacion. Zakonisht, këto përkufizime i identifikojnë viktimat si individë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të dhunës, duke përfshirë dhunën fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike. Përtej individit të prekur drejtpërdrejt, koncepti i viktimës shtrihet shpesh edhe te viktimat indirekte, si anëtarët e familjes ose personat nën kujdestari, sidomos në rastet kur vepra penale ka rezultuar në humbje jete. Gjithashtu, juridiksionet shpeshherë e njohin cenueshmërinë e fëmijëve duke parashikuar përkufizime të posaçme për “viktimat në moshë të mitur”, zakonisht për personat nën moshën 18 vjeç që kanë pësuar dëme.

Në kuadro të ndryshme ligjore shfaqen edhe koncepte më të gjera të “viktimizimit” dhe “riviktimizimit”. “Viktimizimi” i referohet trajtimit të pafavorshëm ose pasojave negative, veçanërisht në kontekstin e diskriminimit ose raportimit të incidenteve të tilla. “Riviktimizimi” ose “viktimizimi dytësor” adreson dëmet e tjera që mund të pësojë një viktimë, ose nga veprat e lidhura të mëvonshme, ose për shkak të përfshirjes të saj në sistemin e drejtësisë penale.

3.2. Qasje specifike sipas juridiksioneve

- Shqipëria:** Termi “viktimë” është përfshirë në Kodin Penal⁶² për të siguruar përafrimin me standardet ligjore të BE-së. Megjithatë, mungon një përkufizim i përgjithshëm i “viktimës” në ligjet kryesore penale të Shqipërisë. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi (Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me Ligjin nr. 124/2020) nuk e përkufizon drejtpërdrejt viktimën, por e identifikon përmes përkufizimit të formave specifike të diskriminimit, duke përkufizuar qartë vetëm “viktimizimin”. Ligji për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare (Ligji Nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9669, datë 18/12/2006”) bën një përkufizim të posaçëm të “viktimës” në kontekstin e dhunës në familje, duke përfshirë shkeljet e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (Ligji Nr. 37/2017) përkufizon “të miturin viktimë” dhe gjithashtu adreson “riviktimizimin” dhe “viktimizimin dytësor/të përsëritur”.
- Bosnjë-Hercegovina:** Për shkak të strukturës së saj kushtetuese komplekse, Bosnjë-Hercegovina operon me katër sisteme të ndryshme ligjore. Termi “palë e dëmtuar” vazhdon të mbizotërojë në legjislacionin për procedurën penale. Ligji i Procedurës Penale të Bosnjë-Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës nr. 3/2003, 32/2003 – korr., 36/2003, 26/2004, 63/2004, 13/2005, 48/2005, 46/2006, 29/2007, 53/2007, 58/2008, 12/2009, 16/2009, 53/2009 – ligj tjetër, 93/2009, 72/2013 dhe 65/2018), Ligji i Procedurës Penale të Federatës së Bosnjë-Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Federatës së Bosnjë-Hercegovinës nr. 35/03), Ligji i Procedurës Penale të Republikës Srpska (Gazeta Zyrtare e Republikës Srpska, nr. 53/2012, 91/2017, 66/2018 dhe 15/2021) dhe Ligji i Procedurës Penale të Rrethit të Brckos (“Gazeta Zyrtare e Rrethit të Brckos” Nr.34/13, 27/14, 3/19, 16/20, 3/24 dhe 14/24 përdorin të njëjtin përkufizim të termit “palë e dëmtuar” si “një person të cilit i janë shkelur ose rrezikuar të drejtat personale ose pronësore nga një vepër penale”. Ky përkufizim tregon se termi “palë e dëmtuar” përfshin nocionin e viktimës, si të drejtpërdrejtë ashtu edhe jo të drejtpërdrejtë, dhe mund të konsiderohet si sinonim i termit “viktimë”. Ligji i Federatës së Bosnjë-Hercegovinës për dhunën në familje e përkufizon “viktimën” në mënyrë të posaçme si çdo anëtar të familjes që ekspozohet ndaj kësaj dhune. “Viktimizimi” përkufizohet gjithashtu si një formë diskriminimi në ligjet për barazinë gjinore dhe ligjet kundër diskriminimit.
- Kosova:** Kuadri ligjor i Kosovës e përkufizon termin “viktimë” në disa ligje. Kodi i Procedurës Penale (Kodi Nr. 04/L-123, 2012) përdor termin e kombinuar “palë e dëmtuar ose viktimë”, duke lënë kështu disa paqartësi në lidhje me të drejtat dhe pozicionet e tyre të ndryshme. Ligji për kompensimin e viktimave të krimit (Ligji Nr. 05-L/036, 2015) përdor ekskluzivisht termin “viktimë e krimit”, duke e përafruar përkufizimin e tij me Kodin e Procedurës Penale, por duke e zgjeruar atë për qëllime kompensimi për të përfshirë edhe anëtarët e familjes ose personat nën kujdestari. Kodi Penal e përkufizon “viktimën e cenueshme” në bazë të moshës, aftësisë së kufizuar fizike/mendore dhe marrëdhënies me shkelësin. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore (Ligji Nr.

⁶² Kodi i Procedurës Penale i ndryshuar në vitin 2017 (Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, i ndryshuar me ligjin nr 35/2017) dhe Kodi Penal (Ligji nr 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”) zëvendësuan termin “palë e dëmtuar nga një vepër penale” me termin “viktimë e një veprë penale” për të harmonizuar terminologjinë me *Acquis Communautaire*.

08/L-185, 2023) përdor disa terma të ndërlidhur, duke përfshirë termin “viktimë”, “viktimë e pambrojtur”, “i mbijetuar” dhe “palë e mbrojtur”.

- Mali i Zi:** Në Mal të Zi, termi “viktimë” përkufizohet ndryshe në Kodin Penal (Gazeta Zyrtare nr. 70/2003, 13/2004, 47/2006 dhe Gazeta Zyrtare nr. 40/2008, 25/2010, 32/2011, 40/2013 dhe 56/2013, 014/15, 042/15, 058/15, 044/17, 049/17, 003/20) dhe në Ligjin për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunës (Gazeta Zyrtare nr. 035/15), ndërsa Kodi i Procedurës Penale (Gazeta Zyrtare nr. 57/2009, 49/2010, 47/2014, 002/15, 035/15, 058/18 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 116/20 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese) përdor termin “palë e dëmtuar”. Kodi Penal e përkufizon viktimën si një person që ka pësuar dhimbje fizike ose mendore, dëmtim të pronës ose shkelje të të drejtave të njeriut për shkak të një veprimi të paligjshëm. Ligji për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunës jep një përkufizim më të gjerë që përfshin individët që kanë humbur jetën ose kanë pësuar lëndime të rënda trupore ose dëmtime të rënda të shëndetit mendor/fizik nga krimet e dhunshme, edhe nëse nuk kanë qenë në shënjestër të drejtpërdrejtë, ose gjatë ndërhyrjes për të parandaluar një krim ose për të ndihmuar të tjerët. Kodi i Procedurës Penale e përkufizon “palën e dëmtuar” si një person të cilit i është shkelur ose rrezikuar një e drejtë personale ose pronësore nga vepra penale.
- Maqedonia e Veriut:** Legjislacioni i Maqedonisë së Veriut e përkufizon termin “viktimë” në disa ligje. Kodi i Procedurës Penale (Gazeta Zyrtare nr. 150/2010) e bën qartë dallimin midis “viktimës” dhe “palës së dëmtuar”. “Viktima e një vepre penale” përkufizohet në mënyrë gjithëpërfshirëse si çdo individ që ka pësuar dëm, duke përfshirë dëme fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje të pasurisë ose shkelje të tjera të të drejtave që rezultojnë nga një vepër penale. Një përkufizim i ngjashëm gjendet në Kodin Penal (Gazeta Zyrtare nr. 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/14, 132/14, 248/2018) për termin “viktimë e krimit”. Kodi Penal njih gjithashtu kategoritë e cënueshme të njerëzve si të miturit, viktimat e rrezikuara (personat në rrezik për shkak të dhënies së deklaratave) dhe viktimat veçanërisht të cënueshme (për shkak të moshës, aftësisë së kufizuar, pasojave të krimit, historikut social/kulturor ose sjelljes së të pandehurit/bashkëpunëtorëve). Termi “palë e dëmtuar” në Kodin e Procedurës Penale i referohet individëve të cilëve u janë shkelur ose rrezikuar të drejtat personale ose pronësore dhe të cilët përfshihen në procedurat penale për ndjekje penale ose pretendime pronësore. Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve (Gazeta Zyrtare nr. 38/05) përfshin një përkufizim të posaçëm për “viktimën që paraqitet në cilësinë e dëshmitarit”, dhe Ligji për Drejtësinë për të Mitur (Gazeta Zyrtare nr. 87/2023) e përkufizon “të miturin viktimë” si çdo të mitur nën 18 vjeç që ka pësuar dëm nga një vepër penale.
- Serbia:** Kuadri legjislativ i Serbisë përdor termin “viktimë”, por nuk jep një përkufizim të përgjithshëm. Në Kodin Penal (Gazeta Zyrtare nr. 85/05, 88/05 – korrigjim, 107/05 – korrigjim, 72/09, 111/09, 121/12, 104/13, 108) kur përdoret termi “viktimë”, përgjithësisht u referohet viktimave të drejtpërdrejta. Kodi i Procedurës Penale (Gazeta Zyrtare nr. 72/2011, 101/2011, 121/2012, 32/2013, 45/2013, 55/2014, 35/2019, 27/2021 - Vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe 62/2021 - Vendimi i Gjykatës Kushtetuese) e përkufizon “palën e dëmtuar” si një person të cilit i është shkelur ose rrezikuar një e drejtë personale ose pronësore nga një vepër penale. Ky përkufizim i “palës së dëmtuar” përdoret edhe në Ligjin “Për të miturit dhe mbrojtjen penale të të miturve” (Gazeta Zyrtare nr. 85/2005). Ligji “Për ekzekutimin e sanksioneve penale” (Gazeta

Zyrtare nr. 55/2014, 35/2019) përdor termin “viktimë” në një nen që lidhet me informimin e viktimave për vepra të caktuara penale, duke nënkuptuar viktimat e drejtpërdrejta. Ndërsa ligji “Për parandalimin e dhunës në familje” (Gazeta Zyrtare nr. 94/2016 dhe 10/2023 - ligji tjetër) e njeh termin “viktimë”, por nuk e përkufizon atë. Në mënyrë të ngjashme, ligji “Për mbrojtjen sociale” (Gazeta Zyrtare nr. 24/2011 dhe 117/2022 - Vendimi i Gjykatës Kushtetuese) përdor termin “viktimë” në lidhje me përdoruesit e shërbimeve të mbrojtjes sociale, siç janë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, abuzimit, neglizhencës, dhunës, shfrytëzimit dhe vetëneglizhimit, duke iu referuar kryesisht viktimave të drejtpërdrejta të formave specifike të viktimizimit.

3.3. Të drejtat e viktimave të dhunës me armë: Analizimi fillestar i mangësive

Një tipar i përbashkët në të gjashtë juridiksionet është mungesa e dispozitave të posaçme ose e një pozicioni të veçantë për viktimat në kodet e procedurës penale ose në legjislacionin përkatës. Viktimat e veprave penale të kryera me armë zjarri kanë përgjithësisht të njëjtin status dhe të njëjtat të drejta si viktimat e llojeve të tjera të veprave penale. Ndonëse kuadrot më të gjera për të drejtat e viktimave zbatohen automatikisht për to, legjislacioni rrallëherë i adreson nevojat e tyre unike për shërbime mbështetëse.

Analiza e kuadrove ligjore dhe politike në të gjashta juridiksionet nxjerr në pah të përbashkëta të konsiderueshme, por dhe dallime specifike për sa u përket mangësive të identifikuara në lidhje me të drejtat e viktimave të dhunës me armë.

3.3.1. Karakteristikat e përbashkëta të identifikuara në të gjithë rajonin

Një mangësi thelbësore në të gjashta juridiksionet është mungesa e një pozicioni të veçantë ose e dispozitave të përshtatura për viktimat e veprave penale të kryera me armë zjarri në procedurën penale. Në përgjithësi, legjislacioni përkatës në të gjashta juridiksionet nuk u referohet në mënyrë specifike nevojave specifike të viktimave të dhunës me armë. Rrjedhimisht, nuk ka asnjë kërkesë legjislative për të krijuar ose përmirësuar shërbime mbështetëse të përshtatura në mënyrë të posaçme për nevojat e viktimave të dhunës me armë, si ato të drejtpërdrejta ashtu edhe ato jo të drejtpërdrejta. Kjo tregon se kuadrot ligjore ekzistuese nuk janë aq gjithëpërfshirëse sa të mbështesin ofrimin e ndihmës së mjaftueshme për viktimat e dhunës me armë dhe nuk përputhen me Direktivën për të Drejtat e Viktimave.

Një tipar i përbashkët është mospërputhja e përkufizimit ligjor të termit “viktimë” krahasuar me instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale, veçanërisht me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit dhe Direktivën për të Drejtat e Viktimave. Këto përkufizime shpesh nuk përfshijnë plotësisht anëtarët e familjes, personat nën kujdestari ose persona të tjerë që janë viktima jo të drejtpërdrejta të krimit.

Një tjetër karakteristikë e përbashkët është fakti që autoritetet përgjegjëse, në shumicën e rasteve, kanë pak ose aspak detyrim ligjor për t’i informuar viktimat e krimit mbi rreziqet dhe mënyrat e parandalimit të viktimizimit dytësor dhe të përsëritur, intimidimit dhe hakmarrjes së mundshme. Në

mënyrë të ngjashme, e drejta e viktimës për të aksesuar shërbime mbështetëse, veçanërisht shërbime të specializuara si akomodimi i sigurt për ata që janë në rrezik riviktimizimi, shpesh është e kufizuar ose nuk është e sanksionuar plotësisht në legjislacionin procedural penal. Kjo përfshin mungesën e kërkesave të qarta për shërbimet mbështetëse që duhet të jenë të disponueshme para, gjatë dhe për një kohë të përshtatshme pas procedurave penale.

Ç’është më e rëndësishmja, legjislacioni dhe politikat që lidhen me armët e zjarrit në të gjitha juridiksionet nuk trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e viktimave të dhunës me armë ose me ofrimin e shërbimeve mbështetëse të lidhura me to.

3.3.2. Faktorët specifikë sipas juridiksioneve

Ndonëse mangësitë kryesore janë të ngjashme, legjislacioni i çdo juridiksioni paraqet veçori të veçanta:

• Serbia:

- Legjislacioni penal dhe ai procedural penal përdor termin “viktimë” pa e përkufizuar atë, duke çuar në paqartësi në lidhje me kuptimin e saktë ligjor të tij.
- Strategjia Kombëtare për Realizimin e të Drejtave të Viktimave dhe Dëshmitarëve të Veprave Penale (2020–2025) e përkufizon “viktimën” në përputhje me Direktivën e BE-së, por i mungon një referencë e posaçme për nevojat për mbështetje për viktimat e incidenteve të lidhura me armët e zjarrit.
- Legjislacioni nuk përfshin detyrimin e autoriteteve për të informuar viktimat mbi shërbimet mbështetëse të disponueshme ose për t’i informuar ato mbi rreziqet e viktimizimit dytësor, intimidimit dhe hakmarrjes. Kjo mangësi vlen edhe për “dëshmitarët veçanërisht të cenueshëm” dhe “dëshmitarët e mbrojtur”.
- Nuk ekziston një detyrim i përgjithshëm ligjor që autoritete të caktuara të ofrojnë mbështetje për viktimat e krimit ose t’i informojnë ato mbi shërbimet e disponueshme, pavarësisht nëse vepra penale është raportuar apo jo.

• Maqedonia e Veriut:

- Përkufizimet e “viktimës së krimit” në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale nuk përputhen plotësisht me standardet ndërkombëtare, duke lënë jashtë viktimat jo të drejtpërdrejta.
- Kodi i Procedurës Penale parashikon një gamë të kufizuar shërbimesh mbështetëse dhe autoritetet nuk janë të detyruara të informojnë viktimat për mbështetjen e specializuar, akomodimin alternativ ose rreziqet e riviktimizimit.
- Të drejtat e palës së dëmtuar në Kodin e Procedurës Penale nuk përfshijnë të drejtën për mbështetje ose informim në lidhje me shërbimet e disponueshme.
- Legjislacioni nuk merr në konsideratë të drejtën e viktimave të krimit për të pasur akses në mbështetje para dhe pas procedurave penale.

• Mali i Zi:

- Përkufizimi i “viktimës” në Kodin Penal nuk përputhet me përkufizimet ndërkombëtare, pasi lë jashtë viktimat e cenimit të rëndë të të drejtave themelore dhe viktimat jo të drejtpërdrejta.



- Përdorimi i termit “palë e dëmtuar” në Kodin e Procedurës Penale është i ngushtë dhe nuk është i harmonizuar me instrumentet ndërkombëtare.
- Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme nuk parashikon përfshirjen e viktimave jo të drejtpërdrejta.
- Kodi i Procedurës Penale nuk përmban asnjë dispozitë për të drejtën e viktimave të krimit (palëve të dëmtuara) për të pasur akses në shërbimet mbështetëse. Përfshirja e vetëm është Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

• Kosova:

- Përkufizimi i “viktimës” në Kodin e Procedurës Penale nuk është plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, pasi lë jashtë personat nën kujdestari.
- Përdorimi jo i njëtrajtshëm i termave “viktimë” dhe “palë e dëmtuar” në legjislacionin përkatës mund të çojë në paqartësi për sa u përket pozicioneve dhe të drejtave të tyre.
- Legjislacioni nuk kërkon shprehimisht që shërbimet mbështetëse të përshtaten me cenueshmërinë specifike të viktimave të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të dhunës me armë.
- Kërkesa e Kodit të Procedurës Penale për zhvillimin e procedurave në bazë të nevojave dhe rrethanave të posaçme të veprës penale nënkupton se për ofrimin e mbështetjes duhet të merret parasysh ashpërsia e veprave penale të kryera me armë zjarri.

• Bosnjë-Hercegovina:

- Përkufizimi i “viktimës” nuk përfshihet në legjislacionin e procedurës penale, gjë që nuk bie ndesh me standardet ndërkombëtare.
- Legjislacioni procedural penal përdor termin “palë e dëmtuar”, duke i dhënë atij një përkufizim më të ngushtë se standardet ndërkombëtare.
- Ligjet në përgjithësi nuk parashikojnë detyra për organet qeveritare për të ofruar ose financuar shërbime mbështetëse për viktimat e krimit, ose për t’i ofruar ato në bazë të trajtimit të barabartë.
- Anëtarët e familjes nuk konsiderohen palë të dëmtuara pavarësisht dëmeve të mundshme.

• Shqipëria:

- Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi Penal nuk kanë një përkufizim të përgjithshëm të termit “viktimë”.
- Përkufizimet në ligje të veçanta, siç është Ligji për Masat kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, nuk janë plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, sepse ato nuk përfshijnë viktimat jo të drejtpërdrejta.
- Legjislacioni nuk parashikon detyrën e autoriteteve për të siguruar që viktimat të mbështeten në një mënyrë që respekton të drejtën e tyre për trajtim të barabartë.
- Ndonëse për vepra penale specifike (trafikimi i qenieve njerëzore, dhuna seksuale, dhuna në familje) parashikohet e drejta për shërbime të përgjithshme dhe të specializuara, duke përfshirë strehimin alternativ, kjo nuk është një e drejtë e përgjithshme që zbatohet edhe për viktimat e tjera të dhunës me armë zjarri.



NJOHURI EMPIRIKE MBI SHËRBIMET
E MBËSHTETJES SË VIKTIMAVE NË TË
GJITHË BALLKANIN PERËNDIMOR

4. NJOHURI EMPIRIKE MBI SHËRBIMET E MBËSHTETJES SË VIKTIMAVE NË TË GJITHË BALLKANIN PERËNDIMOR

Për të bërë një përmbledhje të shërbimeve dhe mekanizmave ekzistues të mbështetjes së viktimave për viktimat e krimit - veçanërisht ato që preken nga incidentet e lidhura me armët e zjarrit - në gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, SEESAC kreu studime përmes VDS. Kjo përfshiu një shqyrtim të kuadrove ligjore përkatëse, një analizë të literaturës aktuale mbi nevojat dhe shërbimet e viktimave dhe vlerësimin e parë empirik të shërbimeve mbështetëse për viktimat e krimit. Qëllimi ishte të fitoheshin njohuri mbi nivelin dhe cilësinë e mbështetjes së disponueshme për viktimat e dhunës me armë.

Studimi empirik kishte dy objektiva kryesore: 1) të kuptohej gjendja aktuale e mekanizmave dhe shërbimeve mbështetëse të disponueshme për viktimat e krimit në përgjithësi, dhe viktimat e dhunës me armë zjarri në veçanti, dhe 2) të identifikoheshin mangësitë në mekanizmat ekzistues të mbështetjes për viktimat, në mënyrë që të hartoheshin rekomandime për përmirësimin e mbështetjes për viktimat në përgjithësi dhe të mbështetjes për viktimat e dhunës me armë në veçanti. Për të arritur këto qëllime, përmes një pyetësoi anketimi, u realizua mbledhja e të dhënave mbi shërbimet ekzistuese të mbështetjes së viktimave, të ofruara nga autoritetet⁶³, agjencitë e pavarura⁶⁴ dhe OShC-të.

Pyetësoi përfshinte pyetje të mbyllura dhe të hapura, dhe përbëhej nga dy pjesë kryesore: 1) Të dhëna mbi shërbimet e mbështetjes së viktimave (p.sh., misioni, të dhënat e kontaktit, statusi ligjor, kapacitetet, regjistrimi i të dhënave etj.), dhe 2) Informacion mbi ndihmën dhe mbështetjen për viktimat (p.sh. grupet e synuara për sa u përket karakteristikave personale dhe formave të viktimizimit, vendndodhjes dhe shtrirjes gjeografike të shërbimeve të ofruara, formave të mbështetjes për viktimat, mënyrave të ofrimit të mbështetjes për viktimat, specifikave të mbështetjes dhe ndihmës për viktimat e incidenteve me armë zjarri, nëse ka).

Për të kuptuar më mirë se si funksionojnë në praktikë mekanizmat mbështetës për viktimat e incidenteve të lidhura me armët e zjarrit, të anketuarve iu kërkua të përshkruanin të paktën një rast dhune ose forme tjetër viktimizimi ku ishin përfshirë armët e zjarrit dhe mënyrën se si ata kishin ofruar ndihmë dhe mbështetje për viktimat. Në pjesën e fundit të pyetësoit, të anketuarve iu kërkua të

⁶³ Autoriteti u referohet kryesisht degëve ekzekutive dhe gjyqësore në juridiksionet e anketuara, siç janë gjykatat, prokuroritë dhe shërbimet e ndihmës juridike.

⁶⁴ Agjencitë e pavarura i referohen autoritetit mbrojtës të qytetarëve (institucionet e avokatit të popullit).



tregonin se si i perceptojnë sfidat më të mëdha në ofrimin e mbështetjes për viktimat e incidenteve me armë zjarri, bashkëpunimin e tyre me subjektet e jashtme për të përmirësuar shërbimet, si dhe pikëpamjet e tyre mbi përmirësimet e mundshme në mbështetjen e viktimave dhe përmirësimet e mundshme në punën dhe kapacitetet e tyre në këtë fushë. Në fund, të anketuarve iu la hapësirë për të dhënë komente dhe sugjerime të tjera dhe për të referuar edhe organizata dhe institucione të tjera që ofrojnë mbështetje për viktimat në juridiksionin e tyre për t'u përfshirë në sondazh.

Procesi i mbledhjes së mostrave përfshiu hartimin e një liste gjithëpërfshirëse të organizatave përkatëse që ofrojnë mbështetje për viktimat, duke përfshirë ato të prekura nga dhuna me armë. Kjo u arrit në dy mënyra:

- a) Përmes përdorimit të burimeve ekzistuese, duke përfshirë literaturën dhe bazat e të dhënave të shërbimeve të mbështetjes për viktimat, dhe
- b) Përmes shfrytëzimit të kontakteve lokale me ndihmën e personave të kontaktit në secilin juridiksion.

Një mostër fillestare u përcaktua⁶⁵ dhe më pas u zgjerua gjatë mbledhjes së të dhënave duke përdorur metodën e “topit të dëborës” për të përfshirë në hartëzim sa më shumë shërbime përkatëse që të ishte e mundur.

Duke u bazuar te lista fillestare e të anketuarve të mundshëm dhe shtesat e mëvonshme gjatë mbledhjes së të dhënave, u dërguan letra shoqëruese për pjesëmarrjen në anketë drejtuar 435 organizatave, duke përfshirë:

- 234 autoritete (53,8%)
- 13 agjenci të pavarura (3%)
- 178 organizata të shoqërisë civile (40,9%)

Në total u plotësuan 189 pyetësorë, 182 prej të cilëve janë të vlefshëm⁶⁶. Mostra përfundimtare konsistonte në 182 subjekte, duke përfshirë autoritetet publike, agjencitë e pavarura dhe OShC-të. Niveli i përgjigjes ishte 41,8%. Përbërja e të anketuarve:

- 106 autoritete (58,2%)
- 2 agjenci të pavarura (1,1%)
- 74 organizata të shoqërisë civile (40,7%)

Është e rëndësishme të theksohet se organizatat e grave përfaqësojnë pjesën më të rëndësishme të OShC-ve në mostër. Gjithashtu, në njërin prej juridiksioneve, institucionet publike nuk dhanë informacion dhe në katër juridiksione, institucionet e pavarura nuk iu përgjigjën anketës.

Të dhënat empirike të paraqitura në këtë dokument janë orientuese dhe nuk duhet të konsiderohen si përfundimtare, për shkak të niveleve të pabarabarta të përgjigjes nga institucionet dhe OShC-të në gjashtë juridiksionet. Pavarësisht mungesës së përfaqësimit të barabartë në mostër, gjetjet tregojnë tendencat e përgjithshme dhe karakteristikat dalluese brenda fushave të vrojuara të mbështetjes së viktimave.

⁶⁵ Një listë fillestare e të anketuarve të mundshëm për secilin juridiksion u nda dhe u diskutua me SEESAC para fillimit të mbledhjes së të dhënave.

⁶⁶ Në total, shtatë pyetësorë nuk ishin të vlefshëm: pesë nga Serbia, një nga Kosova dhe një nga Shqipëria.



4.1. Ofruesit e shërbimeve të mbështetjes së viktimave: Statusi, misioni dhe kapacitetet

Në gjashtë juridiksionet, mbështetja e viktimave ofrohet nga një përzierje e larmishme e OShC-ve, institucioneve publike (si gjykatat dhe prokuroritë) dhe agjencive të pavarura si zyrat e Avokatit të Popullit. OShC-të në përgjithësi fokusohen tek advokimi, mbrojtja e të drejtave të viktimave dhe ndihma e drejtpërdrejtë, veçanërisht për grupet e cenushme si gratë dhe fëmijët. Autoritetet përqendrohen kryesisht në forcimin e shtetit të së drejtës dhe sigurimin e aksesit në drejtësi. Agjencitë e pavarura, si Avokati i Popullit në Shqipëri ose Mbrojtësi i Qytetarëve në Serbi, përqendrohen në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në forcimin e shtetit të së drejtës. Në Kosovë, OShC-të e anketuara theksojnë fuqizimin e viktimave përmes përmbushjes së nevojave të tyre praktike, duke ofruar ndihmë sociale dhe duke lehtësuar riintegrimin afatgjatë. Departamentet e Mbështetjes së Dëshmitarëve në Bosnjë-Hercegovinë ofrojnë mbështetje të specializuar psikologjike për dëshmitarët gjatë të gjitha procedurave ligjore.

Mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave për viktimat dhe shërbimet e mbështetjes së viktimave:

Shumica e ofruesve të shërbimeve në të gjitha juridiksionet mbajnë baza të dhënash për të regjistruar informacionin mbi viktimat dhe mbështetjen e ofruar, duke përfshirë seksin, kombësinë dhe llojin e shërbimit. Megjithatë, ekzistojnë përjashtime, si në rastin e disa autoriteteve dhe OShC-ve të anketuara në Bosnjë-Hercegovinë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut që kanë raportuar mangësi të perceptuara në mbledhjen sistematike të të dhënave.

Mbështetja dhe ndihma për viktimat – grupet kryesore të synuara:

Shërbimet e mbështetjes së viktimave janë gjerësisht të aksesueshme për të gjitha viktimat pavarësisht nga gjinia dhe karakteristikat e tjera personale. Megjithatë, shumica e OShC-ve të anketuara janë të specializuara në ndihmën për gratë, vajzat dhe fëmijët e prekur nga dhuna. Shumica e ofruesve mbështesin viktimat e të gjitha grupmoshave. Ndonëse përgjithësisht adresohet dhuna në familje, dhuna seksuale dhe trafikimi i qenieve njerëzore, ekziston mbështetje e specializuar edhe për grupe të tjera specifike. Për shembull, një organizatë në Shqipëri fokusohet tek djemtë deri në 14 vjeç dhe disa OShC në Maqedoninë e Veriut ofrojnë ndihmë për grupet e marxhinalizuara, si punonjësit e seksit dhe të pastrehët.

Informimi i viktimave për mbështetjen e disponueshme:

Në të gjashtë juridiksionet e anketuara, shpërndarja e informacionit bazohet gjerësisht te materialet e printuara, faqet e internetit dhe mediat sociale. Shqipëria përdor gjithashtu takime të komuniteteve lokale për shkëmbim informacioni. Bosnjë-Hercegovina ka një praktikë të mirë të përfshirjes së njoftimeve për mbështetjen e dëshmitarëve në fletëthirrjet në gjykatë, ndërsa, sipas OShC-ve të anketuara, Kosova thekson mediat sociale si kanal kryesor.

Ofrimi i mbështetjes për viktimat:

Kontakti i drejtpërdrejtë dhe mbështetja përmes telefonit janë metodat më të përhapura të asistencës së ofruar për viktimat, së bashku me emailin dhe mediat sociale. Shërbimet ofrohen përgjithësisht falas. Në Bosnjë-Hercegovinë, një OShC raportoi se ofronte vizita në shtëpi, gjë që është e paprecedentë mes organizatave të anketuara.

Shtrirja gjeografike e shërbimeve mbështetëse për viktimat

Në të gjashtë juridiksionet, shërbimet mbështetëse janë përgjithësisht të disponueshme ose në të gjithë juridiksionin, ose brenda rajoneve më të vogla specifike. Serbia spikat me një shumicë ofruesish (65,4%) që ofrojnë shërbime në mbarë vendin, ndërsa në Bosnjë-Hercegovinë, është më e përhapur mbështetja rajonale.



Bashkëpunimi me shërbime të tjera për përmirësimin e mbështetjes për viktimat: Bashkëpunimi i gjerë është një tipar i zakonshëm dhe shumica e ofruesve raportojnë bashkëpunim ekzistues me policinë, prokuroritë, gjykatat, qendrat e punës sociale, OShC-të dhe institucionet e kujdesit shëndetësor.

Raportet tek institucionet dhe grupet e tjera të interesit Shumica e ofruesve të shërbimeve i raportojnë rregullisht aktivitetet e tyre tek donatorët e tyre ose tek institucione publike të caktuara. OShC-të zakonisht raportojnë te financuesit e projekteve, ndërsa autoritetet paraqesin raporte pranë organeve më të larta gjyqësore dhe ministrive të drejtësisë. Një shembull që spikat është Avokati i Popullit i Shqipërisë, raportet e të cilit përdoren për të kontribuar në përmirësimin e rregulloreve ligjore. Mbrojtësi i Qytetarëve në Serbi paraqet raporte vjetore direkt pranë Asamblesë Kombëtare.

Kapacitetet e ofruesve të mbështetjes për viktimat

Ekziston një ndryshim i dukshëm midis institucioneve publike dhe OShC-ve të anketuara, si në lidhje me stafin, ashtu edhe në lidhje me fondet e disponueshme. OShC-të zakonisht mbështeten në fonde donatorësh të lidhura me projekte afatshkurtra, gjë që cenon vazhdimësinë e shërbimeve. Në disa juridiksione, zbatohet një qasje e përzier financimi, ku shërbime të caktuara thelbësore të ofruara nga OShC-të financohen përmes një kombinimi të fondeve qeveritare dhe atyre të donatorëve.


Burimet njerëzore: Burimet njerëzore të dedikuara për mbështetjen e viktimave në mbarë rajonin përfshijnë përgjithësisht avokatët, psikologët dhe punonjësit socialë si profesione dominuese. Autoritetet kanë shpeshherë staf më të madh, ndërsa OShC-të zakonisht veprojnë me ekipe më të vogla.

Burimet financiare: Qëndrueshmëria financiare varion ndjeshëm nga njëra organizatë e anketuar në tjetrën. Autoritetet financohen pothuajse ekskluzivisht nga buxhetet qeveritare. OShC-të, nga ana tjetër, varen shumë nga fondet e huaja, grantet dhe donacionet për projektet e tyre. Disa OShC marrin fonde të pjesshme qeveritare, veçanërisht për shërbime thelbësore si strehat e sigurta dhe linjat e ndihmës. OShC-të në Kosovë mbështeten gjithashtu në donacionet filantropike dhe tarifën e anëtarësimit, një praktikë e zbatuar edhe nga një OShC e anketuar në Maqedoninë e Veriut.

4.2. Një panoramë e përgjithshme e mbështetjes për viktimat e krimit në vitin 2023

Numri i viktimave të mbështetura në vitin 2023 varionte ndjeshëm, me shifra që luhateshin nga më pak se 50 deri në mbi 500 raste.

Mbështetja për viktimat e incidenteve me armë zjarri: Mbështetja e drejtpërdrejtë për viktimat e incidenteve me armë zjarri perceptohet përgjithësisht si e kufizuar. Në shumicën e rasteve, viktimat kërkojnë mbështetje psikologjike dhe emocionale, ndihmë ligjore dhe informacion në lidhje me të drejtat e tyre. Kohëzgjatja e mbështetjes varion nga asistenca e njehershme në atë afatgjatë. Shumica e ofruesve të anketuar nuk kishin vërejtur tendenca specifike për sa u përket viktimave të dhunës me armë zjarri, krahasuar me viktimat e tjera. Megjithatë, u shfaqën disa specifika të dukshme: pjesëmarrësit e anketuar nga Shqipëria theksuan mungesën e strehave afatgjata, Bosnjë-Hercegovina vuri në dukje dallimet e dukshme emocionale dhe të sjelljes te dëshmitarët e krimeve të luftës dhe Mali i Zi vuri në dukje frikën e vazhdueshme nga armët e zjarrit. Organizatat e anketuara në Serbi vunë re se viktimat përjetonin një ndjesi pasigurie dhe se të mbijetuarit kishin nevojë për mbështetje të vazhdueshme dhe fuqizim.



5

SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT NË OFRIMIN
E MBËSHTETJES PËR VIKTIMAT E DHUNËS
SË LIDHUR ME ARMËT E ZJARRIT

5. SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT NË OFRIMIN E MBËSHTETJES PËR VIKTIMAT E DHUNËS SË LIDHUR ME ARMËT E ZJARRIT

Ofrimi i mbështetjes gjithëpërfshirëse për personat e prekur nga dhuna me armë në të gjashta juridiksionet paraqet një sërë sfidash komplekse dhe mundësish për përmirësim, veçanërisht në fushën e politikave dhe legjisllacionit të lidhur me kontrollin e AVL-ve, duke pasur parasysh rrjetin rajonal ekzistues të institucioneve të sigurisë të mundësuar nga SEESAC.

Megjithëse ekziston një angazhim i qartë për mbështetjen e viktimave, përpjekjet për t'i përafuar këto shërbime me legjisllacionin përkatës të BE-së, veçanërisht me Direktivën për të Drejtat e Viktimave, dhe me standardet ndërkombëtare, mbeten një proces i vazhdueshëm. Ky përaftrim shpeshherë pengohet nga boshllëqe sistemike, burime të kufizuara dhe specializim ende i pamjaftueshëm në trajtimin e nevojave të veçanta të viktimave të dhunës me armë. Edhe pse të dhënat empirike janë vetëm orientuese, për shkak të niveleve të ndryshme të pjesëmarrjes së institucioneve dhe OShC-ve në anketën rajonale, ato nxjerrin në pah fusha kyç ku nevojiten përmirësime për të garantuar që viktimat të marrin ndihmën e duhur në kohë.

Një sfidë kryesore e vërejtur në të gjashta juridiksionet është **disponueshmëria e kufizuar e mbështetjes së përshtatur për viktimat e incidenteve të lidhura me armët e zjarrit**. Edhe pse shërbimet e përgjithshme të mbështetjes për viktimat janë përgjithësisht të aksesueshme, ndihma e përshtatur posaçërisht për traumat e thella dhe nevojat unike të të mbijetuarve të dhunës me armë ofrohet rrallë, sipas rezultateve të anketës. Shumë ofrues shërbimesh raportojnë se kanë ndihmuar një numër relativisht të vogël të viktimave të tilla. Kjo tregon për mangësi të mundshme për sa i përket kontaktit të dedikuar, protokolleve të identifikimit ose njohjes së plotë të kompleksitetit psikologjik, fizik dhe ligjor që karakterizon viktimizimin në incidentet me armë zjarri. Një qasje e tillë e përgjithësuar ndaj shërbimeve për viktimat rrezikon të anashkalojë nevojat e larmishme të individëve të prekur nga dhuna me armë, gjë që mund të çojë në mbështetje të pamjaftueshme ose të pakalibruar me nevojat e tyre reale.

Sfidat me mbledhjen dhe raportimin gjithëpërfshirës të të dhënave pengojnë zhvillimin e politikave të bazuara në prova dhe ndërhyrjeve të targetuara. Edhe pse shumica e ofruesve të shërbimeve mbajnë baza të dhënash, të dhënat specifike që kanë të bëjnë me viktimat e dhunës me armë mund të mos përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm. Për të përafuar reagimin e juridiksioneve me legjisllacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, është thelbësore që të arrihet një njohje sa më



e plotë e përhapjes, karakteristikave dhe ndikimeve afatgjata të dhunës me armë, si dhe të bëhet një vlerësim i mekanizmave aktualë të mbështetjes.⁶⁷

Një sfidë tjetër lidhet me **aksesin e kufizuar në ngritjen e kapaciteteve për profesionistët e mbështetjes për viktimat**, veçanërisht në fushat që kanë të bëjnë me ndikimet psikologjike afatgjata dhe rrezikun e ritraumatizimit të viktimave gjatë procedurave ligjore. Kjo theksohet edhe nga fakti se shumica e ofruesve të shërbimeve që morën pjesë në anketë u shprehën se nuk kishin vërejtur ndonjë tendencë specifike apo kërkesa të veçanta për mbështetje që i dallojnë viktimat e dhunës me armë nga viktimat e formave të tjera të dhunës. Kjo tregon se mund të ketë pasur mangësi në identifikimin dhe trajtimin e nevojave të veçanta, si pasojë e nivelit të lartë të frikës, pasigurisë së thellë dhe brengave komplekse që shfaqen pas incidenteve me armë zjarri. Edhe pse juristët, psikologët dhe punonjësit socialë përbëjnë bërthamën e ekipeve të mbështetjes së viktimave, shumë pak prej tyre kanë formim të specializuar apo ekspertizë në lidhje me adresimin e traumave nga dhuna me armë.

Nga ana tjetër, **burimet e kufizuara** përbëjnë një pengesë të konsiderueshme për ofrimin e mbështetjes së duhur për viktimat. Institucionet publike financohen kryesisht nga buxhetet e qeverisë qendrore ose vendore, ndërsa OShC-të, të cilat shpesh ofrojnë mbështetje më të drejtpërdrejtë dhe gjithëpërfshirëse, varen shumë nga fondet e huaja, grantet dhe donacionet e pasigurta. Ky model financimi i bazuar në projekte shpeshherë e kufizon qëndrueshmërinë dhe planifikimin afatgjatë të programeve të specializuara për viktimat e dhunës me armë. Mungesa e burimeve të qëndrueshme dhe të dedikuara të financimit, të alokuara posaçërisht për shërbimet për viktimat, pengon krijimin e sistemeve mbështetëse të forta e të qëndrueshme, duke përfshirë ndërhyrjet terapeutike të specializuara dhe akomodimet e sigurta të përshtatura për viktimat që përballen me rreziqe të rënda të sigurisë.

Përveç këtyre sfidave të përgjithshme, të anketuarit vunë në dukje edhe disa sfida të tjera të një natyre më specifike, të ndara në këto kategori:

Sfidat në lidhje me kontrollin e armëve të zjarrit: Disa sfida burojnë nga mekanizmat që rregullojnë kontrollin e armëve të zjarrit. Gjetjet e studimit empirik tregojnë se ka një perceptim të gjerë se legjislacioni për posedimin e armëve nuk është mjaftueshëm i rreptë dhe se proceset dhe mjetet për lëshimin e lejeve për armë zjarri duhet të përmirësohen. Shpesh, gjatë procesit të pajisjes me leje, nuk konsultohen sistemet përkatëse që sinjalizojnë masat urgjente mbrojtëse, shqetësimet lidhur me sigurinë apo njoftimet e mëparshme për dhunë në familje. Është theksuar edhe nevoja për bashkëpunim më të mirë ndërmjet aktorëve përgjegjës për lëshimin e lejeve dhe institucioneve të tjera që mund të kenë informacion të rëndësishëm (si qendrat e punës sociale), si dhe rëndësia e kontroleve të rregullta lidhur me mënyrën e ruajtjes së armëve pas lëshimit të lejes. Duhet siguruar që kriteret për dhënien e lejeve të monitorohen siç duhet dhe, nëse nuk përmbushen, atëherë leja të tërhiqet. Gjithashtu, ekziston perceptimi i përgjithshëm se qytetarët nuk kanë informacion të mjaftueshëm dhe ndërgjegjësim për përgjegjësitë që lidhen me mbajtjen dhe përdorimin e armëve të zjarrit.

Sfidat në lidhje me mbështetjen për viktimat: Përveç mungesës së burimeve dhe specializimit, gjetjet e anketës theksuan edhe disa sfida më specifike për sa i përket ofrimit të mbështetjes për viktimat.

⁶⁷ Mekanizmi i mbështetur nga SEESAC për mbledhjen e të dhënave për armët e zjarrit përmes AVMP është një burim i rëndësishëm me një mori informacionesh mbi incidentet e lidhura me armët e zjarrit. Megjithatë, deri më sot, informacioni mbi mbështetjen për viktimat e dhunës me armë zjarri përmendet rrallë, kryesisht për shkak se nuk është i disponueshëm.



Ndër to përfshihet mungesa e një mbështetjeje gjithëpërfshirëse, sistematike dhe të vazhdueshme për viktimat, gjë që tregon për një qasje të fragmentuar ndaj ndihmës afatgjatë. Shpeshherë, viktimat nuk marrin informacion të mjaftueshëm për shërbimet ekzistuese të mbështetjes për viktimat, çka u pengon aksesin e shpejtë të ndihmës që u nevojitet.


Sfidat në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje: Në rastet e femicidit vërehet mungesë shkëmbimi informacioni midis institucioneve kompetente, si dhe mungesa e një analize të përgjithshme për mënyrën si kanë vepruar institucionet në raste të tilla. Kjo mungesë rishikimi dhe komunikimi ndërinstitucional dobëson përpjekjet për të parandaluar incidente të ardhshme dhe për të mësuar nga trajtimi i rasteve të së shkuarës. Në kontekstin e dhunës në familje, vijnë mangësitë në vlerësimin e rrezikut. Prania e armëve nuk trajtohet gjithmonë si një faktor me rrezik të lartë, gjë që çon në një nënvlerësim të ndjeshëm të potencialit për pasoja fatale. Gjithashtu, mospërfshirja e viktimave në procesin e vlerësimit të rrezikut dhe në hartimin e planeve individuale të mbrojtjes bie ndesh me qasjen e fokusuar të viktimat dhe mund të rrezikojë sigurinë e tyre.

Sfidat në lidhje me procedurat hetimore dhe gjyqësore: Procesi ligjor sjell një sërë vështirësish për viktimat, duke përfshirë sfida në lidhje me mbledhjen e provave gjatë fazës së hetimit, gjë që mund ta vështirësojë vënien në vend të drejtësisë. Një shqetësim i madh është rreziku i ekspozimit të mundshëm ndaj viktimizimit dytësor gjatë procedurës, i cili mund të përshkallëzohet nga praktika të tilla si marrja disa herë në pyetje e viktimës. Zgjatja e procedurave penale shpeshherë i lodh viktimat, duke bërë që ato ta humbin motivimin për ta çuar procesin deri në fund.

Sfidat në lidhje me kompensimin dhe zbutjen e pasojave të incidenteve me armë zjarri: Ekziston një boshllëk i konsiderueshëm në aspektin e dëmshpërblimit financiar për viktimat. Ka një mungesë të përgjithshme të fondeve të dedikuara për kompensimin e viktimave të incidenteve me armë zjarri. Ndonëse kjo mbetet një sfidë e përhapur, si praktikë pozitive përmendet shembulli i Maqedonisë së Veriut, e cila është në procesin e krijimit të një fondi kompensimi, një qasje kjo e cila mund të shërbejë si model për juridiksionet e tjera.

Pavarësisht këtyre pengesave të konsiderueshme, ka një sërë nismash dhe **perspektivash premtuese për përmirësim**. Bashkëpunimi tashmë ekzistues midis aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë autoritetet ligjzbatuese, prokurorët, gjykatat, qendrat e punës sociale dhe OShC-të që fokusohen te mbështetja e viktimave, përbën një bazë solide për ndërtimin e një sistemi të koordinuar mbështetjeje për viktimat. Forcimi i këtyre mekanizmave dhe përmirësimi i komunikimit ndërinstitucional, sidomos në raste të ndërlikuara që përfshijnë armë zjarri, mund të mundësojë një mbështetje më të integruar dhe më gjithëpërfshirëse për viktimat. Rritja e ndërgjegjësimit për nevojën e mbështetjes psikologjike dhe emocionale, krahas ndihmës juridike, është një hap pozitiv drejt krijimit të shërbimeve të përshtatshme për viktimat dhe drejt përafrimit me kuadrot ligjore përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale.

Gjithashtu, përvojat e OShC-ve të specializuara në forma specifike të mbështetjes për viktimat mund të ofrojnë njohuri të vlefshme për zhvillimin e qasjeve të targetuara për viktimat e dhunës me armë.



REKOMANDIME

6. REKOMANDIME

Duke u bazuar në një analizë të literaturës aktuale për të drejtat e viktimave, në një përmbledhje të kuadrit ligjor në gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, si dhe në gjetjet orientuese nga përpjekja e parë për të kryer një studim empirik rajonal përmes anketës mbi shërbimet e mbështetjes për viktimat e dhunës me armë, janë hartuar rekomandime për përmirësimin e legjisllacionit, politikave dhe praktikave. Për të adresuar sfidat e identifikuar, nevojitet një qasje strategjike që përshkruan veprimet e rekomanduara për autoritetet e juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor dhe që përfshin sa më poshtë:

Harmonizimi politik dhe ligjor:

1. Përditësimi i kuadrove ligjore dhe politike: Kryerja e një shqyrtimi dhe rishikimi të plotë të kuadrove ligjore përkatëse në çdo juridiksion për të përafuar shërbimet e mbështetjes për viktimat me standardet ndërkombëtare, duke siguruar përfshirjen e dispozitave që adresojnë në mënyrë të posaçme viktimat e dhunës me armë. Kjo duhet të përfshijë hartimin e ndryshimeve ligjore për të përfshirë një përkufizim gjithëpërfshirës të “viktimës”, që mbulon si viktimat e drejtpërdrejta, ashtu edhe ato jo të drejtpërdrejta, sigurimin e përdorimit të terminologjisë konsistente, si dhe saktësimin e detyrimit të autoriteteve për të siguruar informacion dhe akses në shërbimet e mbështetjes. Përfshirja e të drejtës së viktimave të dhunës me armë për informim dhe përfitim nga shërbimet e mbështetjes në kuadrin ligjor dhe politik të lidhur me kontrollin e AVL-ve.

2. Përafrimi i shërbimeve të mbështetjes për viktimat me standardet ndërkombëtare: Zhvillimi i shërbimeve mbështetëse gjeografikisht të aksesueshme, konfidenciale dhe pa pagesë për viktimat. Këto shërbime duhet të përfshijnë të paktën ndihmën e menjëhershme mjekësore, sigurimin e informacionit, mbështetjen psikologjike, ndihmën juridike dhe referimet te shërbimet e duhura të specializuara, duke siguruar mbështetje gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme para, gjatë dhe pas procedurave penale.

Në mënyrë më të detajuar, duhet të zhvillohen kuadro politike dhe ligjore që fokusohen te mbështetja e viktimave, duke siguruar që:

- Kuadrot ligjore të përfshijnë përkufizimin e duhur të “viktimës” në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare dhe Direktivën për të Drejtat e Viktimave
- Autoritetet kompetente të kenë detyrimin ligjor për të mundësuar referimin e viktimave te shërbimet e mbështetjes së viktimave.
- Autoritetet kompetente të kenë detyrimin ligjor të informojnë viktimat e krimit mbi rreziqet dhe parandalimin e viktimizimit dytësor dhe riviktimizimit, intimidimit dhe hakmarrjes së mundshme,



duke marrë parasysh cenueshmërinë specifike dhe nevojat e viktimave të veprave penale të kryera me armë zjarri.

- Legjislati përkates të përfshijë detyrën e juridiksionit për të siguruar që shërbimet e përgjithshme dhe të specializuara të mbështetjes të jenë falas, të disponueshme dhe të aksesueshme për të gjitha viktimat e krimit bazuar në parimin e trajtimit të barabartë, në përputhje me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit dhe Direktivën për të Drejtat e Viktimave
- Mbështetja për viktimat e krimit të jetë e disponueshme dhe e aksesueshme për viktimat jo të drejtpërdrejta (anëtarët e familjes dhe personat nën kujdestarinë e viktimave, si p.sh. fëmijët) në përputhje me nevojat e tyre dhe shkallën e dëmit të pësuar si rezultat i aktit të dhunshëm të kryer me armë zjarri kundër viktimës.
- Të përdoret një qasje proaktive ndaj viktimave, si atyre të drejtpërdrejta, ashtu edhe atyre jo të drejtpërdrejta, duke përfshirë dhënien e menjëhershme të informacionit mbi shërbimet e mbështetjes së viktimave në kohën e raportimit të një krimi (të dhënat e kontaktit dhe mënyrat e adresimit të shërbimeve, duke përfshirë gjykatat, prokurorët, shërbimet e mirëqenies sociale dhe ofruesit e shërbimeve të OShC-ve).
- Pjesëmarrja dhe perspektivat e viktimave të prekura nga dhuna me armë dhe organizatave që i përfaqësojnë ato, duke përfshirë OShC-të, të integrohen në proceset e konsultimit për zhvillimin e politikave të kontrollit të AVL-ve në nivel juridiksional dhe rajonal.

Roli qendror i policisë

3. Përforsimi i qasjes së policisë me në qendër viktimat në ofrimin e mbështetjes dhe mbrojtjes⁶⁸: Policia luan një rol qendror në mbrojtjen e të drejtave të viktimave. Për t'u siguruar që viktimat të ndihen të mbështetura kur raportojnë krime të dhunshme, autoritetet policore duhet të miratojnë një qasje me në qendër viktimën dhe të ndjeshme ndaj traumave. Oficerët e policisë duhet të jenë të mirinformuar për të drejtat e viktimave dhe të aftë t'u përgjigjen nevojave të tyre me profesionalizëm dhe ndjeshmëri. Rritja e aksesueshmërisë së policisë, përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstucional dhe forcimi i mekanizmave të referimit janë thelbësore për ndërtimin e besimit dhe për sigurimin e mbështetjes së koordinuar dhe në kohë për viktimat. Në mënyrë më të detajuar, kjo duhet të përfshijë:

- Kanale raportimi të sigurt dhe të aksesueshme - Viktimat duhet të ndihen të sigurt kur raportojnë krime. Kjo përfshin mundësimin e raportimit të palë të treta nëpërmjet ndërmjetësve të besueshëm, si stafi i OShC-ve ose punonjësit socialë, veçanërisht për grupet e cenueshme.
- Komunikim efektiv dhe mjedis mbështetës - Oficerët e policisë duhet të trajnohen për të komunikuar me ndjeshmëri, duke siguruar që viktimat të dëgjohen, respektohen dhe trajtohen me dinjitet. Intervistat duhet të kryhen në ambiente të sigurt, private dhe jo intimiduese.
- Sisteme të integruara referimi - Policia duhet të bashkëpunojë ngushtë me shërbimet e mbështetjes së viktimave, duke përfshirë ofruesit e kujdesit mjekësor, psikologjik dhe social. Duhet të krijohen kanale të qarta referimi në mënyrë që viktimat të referohen menjëherë të ndihma e duhur.

⁶⁸ Vini re se për shkak të rolit specifik dhe thelbësor të policisë, një rekomandim i kushtohet rolit të saj dhe nevojave të saj për kapacitete. Ky rekomandim bazohet në një studim të gjerë empirik të nevojave të viktimave, të kryer nga Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore, me titull "Stepping up the response to victims of crime: FRA's findings on challenges and solutions. Mund ta gjeni në: <https://fra.europa.eu/en/publication/2024/stepping-response-victims-crime>



- Duhet të miratohen procedura për të siguruar që viktimat të jenë plotësisht të informuara për të drejtat e tyre dhe për shërbimet mbështetëse të disponueshme në çdo fazë të procesit. Viktimat e krimeve të lidhura me armët e zjarrit mund të jenë në gjendje shoku dhe të mos jenë gjendje ta përpunojnë informacionin menjëherë pas incidentit. Është thelbësore që informacioni mbi shërbimet mbështetëse të jepet në forma të ndryshme - me gojë, me shkrim dhe të përsëritet sipas nevojës - për të siguruar që ai të kuptohet dhe të përvetësohet.

Ngritja e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve

4. Organizimi i ngritjes së kapaciteteve dhe trajnimit: Sigurimi i aksesit në programet e trajnimit dhe të ngritjes së kapaciteteve për autoritetet ligjzbatuese, oficerët e policisë gjyqësore, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe OShC-të që fokusohen te mbështetja e viktimave për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për të drejtat e viktimave të dhunës me armë dhe mekanizmat efektivë të mbështetjes. Kjo duhet të mundësojë përgjigje të koordinuara dhe të informuara në të gjithë sektorët dhe përafrimin me Direktivën për të Drejtat e Viktimave.

- Në mënyrë më të detajuar, aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve duhet të fokusohen te:
- Rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit të punonjësve në institucione dhe organizata që bien në kontakt me viktimat e dhunës me armë, duke u përqendruar veçanërisht tek ata që veprojnë më shpesh si pika e parë e kontaktit. Edukimi i tyre në lidhje me të drejtat e viktimave për të shmangur hendekun midis politikave dhe zbatimit të tyre në praktikë.
- Forcimi i kapaciteteve të punonjësve në institucione dhe organizata që bien në kontakt me viktimat e incidenteve të lidhura me armët e zjarrit për të vlerësuar dhe adresuar në mënyrë të përshtatshme nevojat e viktimave dhe për t'u mundësuar atyre të ofrojnë referime dhe mbështetje të vazhdueshme.
- Sigurimi që punonjësit në institucione dhe organizata që bien në kontakt me viktimat e incidenteve të lidhura me armët e zjarrit të kuptojnë llojet e mbështetjes që duhet të jenë në dispozicion të viktimave jo të drejtpërdrejta (më së shumti familjet e personave të vrarë ose të plagosur në incidente të lidhura me armët e zjarrit).

Rritja e vizibilitetit dhe ndërgjegjësimi

Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, për të luftuar stigmatizimin dhe për të advokuar për reforma politike që u japin përparësi qasjeve të përqendruara te viktimat. Në këtë drejtim, është me rëndësi thelbësore:

5. Rritja e vizibilitetit të institucioneve dhe organizatave që punojnë me viktimat e dhunës me armë: Sigurimi që institucionet dhe ofruesit e shërbimeve përkatëse të kenë vizibilitet dhe që publiku i gjerë dhe vetë viktimat të kenë informacion në lidhje me të drejtat e viktimave dhe disponueshmërinë e shërbimeve. Ndarja e këtij informacioni duhet të kontribuojë në përmirësimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis aktorëve kryesorë. Minimalisht, vizibiliteti duhet të sigurohet duke publikuar informacionin përkatës në faqet e internetit të autoriteteve, organizatave ndërkombëtare dhe OShC-ve.

6. Kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit dhe advokimit: Realizimi i fushatave të ndërgjegjësimit të publikut dhe advokimit për të theksuar rëndësinë e mbështetjes së viktimave të dhunës me armë, për të informuar publikun në lidhje me disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse dhe për të theksuar rolin e komuniteteve në nxitjen e një mjedisi më të sigurt. Këto fushata

duhet të synojnë të reduktojnë stigmatizimin, të nxisin raportimin dhe të sigurojnë që viktimat të jenë të vetëdijshme për të drejtat dhe burimet që ato kanë në dispozicion. Mesazhet duhet të përshtaten për audienca të ndryshme dhe të përsëriten me kalimin e kohës. Ato duhet të jenë koncize, të shkurtra dhe të kufizuara në numër, si dhe të mbështetura nga histori dhe statistika. Historitë duhet jo vetëm të jenë të fuqishme dhe tërheqëse, por edhe të ndahen në një mënyrë që mbron privatësinë dhe dinjitetin e viktimave të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta. Për përhapjen e mesazheve duhen përdorur media, materiale dhe aktivitete të ndryshme, të cilat e plotësojnë dhe e përforcojnë njëra-tjetrën.⁶⁹

Nxjerrja e mësimave dhe shkëmbimi i njohurive nga institucionet

7. Sigurimi i monitorimit dhe vlerësimit të rregullt: Zhvillimi i një kuadri të fuqishëm monitorimi dhe vlerësimi për të vlerësuar ndikimin e strategjive të zbatuara dhe për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm. Kjo duhet të përfshijë mbledhjen e të dhënave sistematike dhe të ndara përkatësisht, rishikime të rregullta dhe konsultime me grupet e interesit për të përshtatur strategjitë dhe për të përfshirë mësimet e nxjerra sipas rastit.

Në mënyrë më të detajuar, monitorimi, vlerësimi dhe mësimi duhet të përfshijnë:

- Krijimin e sistemeve të forta dhe gjithëpërfshirëse për mbledhjen e të dhënave mbi viktimat e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të dhunës me armë zjarri.
- Sigurimin që të dhënat të ndahen sipas gjinisë dhe moshës dhe që të kryhet një analizë e përshtatshme gjinore për të informuar politikat dhe praktikën.
- Maksimizimin e përdorimit të të dhënave të mbledhura nga pikat e kontaktit për armët e zjarrit, të cilat janë qendra ekselence dhe përfshijnë informacionin kryesor rreth viktimave.
- Mbështetjen e shkëmbimit të të dhënave dhe informacionit kyç në të gjithë sektorët për të rritur sigurinë dhe për të përmirësuar mbështetjen për viktimat e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të dhunës me armë zjarri.
- Përfshirjen e mbledhjes së të dhënave sasiore dhe cilësore për të mundësuar nxjerrjen e mësimave dhe përmirësime të vazhdueshme të politikave dhe praktikave në lidhje me mbështetjen e viktimave të incidenteve me armë zjarri.
- Zhvillimin e rasteve studimore dhe kryerjen e intervistave me viktimat e dëmtuara ose familjet e personave të vrarë me armë zjarri për të vlerësuar disponueshmërinë e rrjeteve dhe mekanizmave të mbështetjes së viktimave në praktikë.
- Në lidhje me mbledhjen dhe prezantimin e të dhënave, garantimin e marrjes në konsideratë të ndjeshmërive për të shmangur rrezikun e riviktimizimit dhe viktimizimit dytësor të viktimave dhe cenimin e privatësisë së tyre.

8. Forcimi i politikëbërjes së bazuar në prova: Përveç përmirësimit të mbledhjes së të dhënave dhe rrjetëzimit të aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë të përfshirë në garantimin e të drejtave të viktimave dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatshme në kohën e duhur, është e domosdoshme që të konsultohen OShC-të ofruese të shërbimeve në lidhje me politikat që kanë të bëjnë me kontrollin e AVL-ve dhe shërbimet e mbështetjes së viktimave, me qëllim forcimin e masave parandaluese dhe përmirësimin e mbrojtjes së viktimave.

⁶⁹ Rekomandimet e Paketës së Mbështetjes për Ndërgjegjësimin mbi AVL-të – SASP II, SEESAC 2005



9. Pjesëmarrja në bashkëpunimin rajonal dhe ndërtimin e partneriteteve: Nxitja e bashkëpunimit rajonal midis juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor për të ndarë praktikat më të mira, mësimet e nxjerra dhe për të zhvilluar strategji të unifikuara për të mbështetur viktimat e dhunës me armë zjarri. Përdorimi i rrjeteve ekzistuese rajonale të institucioneve të sektorit të sigurisë për të ndarë mësimet e nxjerra dhe për të përshpejtuar proceset e përafrimit me standardet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e viktimave. Vendosja e partneriteteve me organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë OShC-të ndërkombëtare dhe lokale, për të shfrytëzuar burimet dhe ekspertizën.

Si përfundim, për të garantuar që viktimat e dhunës me armë të marrin mbështetjen e duhur, nevojitet një përpjekje e bashkërenduar për të adresuar boshllëqet ekzistuese në kuadrot ligjore, adresimi i nevojave për specializim, shpërndarja më e mirë e burimeve, mbledhja e rregullt dhe e qëndrueshme e të dhënave të ndara, vlerësime gjithëpërfshirëse të rrezikut dhe mbështetje e personalizuar, procedura ligjore që marrin parasysh cenueshmëritë specifike të viktimave të dhunës me armë dhe aksesit i duhur në fondet e kompensimit.

Përmes fuqizimit të kapaciteteve institucionale, sigurimit të financimit të qëndrueshëm për ofruesit e shërbimeve, garantimit të aksesit në trajnim të specializuar dhe nxitjes së bashkëpunimit të fortë ndërsektorial dhe rajonal, juridiksionet e Ballkanit Perëndimor mund të krijojnë në mënyrë progresive një sistem mbështetës më gjithëpërfshirës, të përqendruar te viktimat dhe të ndjeshëm ndaj traumave për të gjithë individët e prekur nga dhuna me armë, që është plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së për mbështetjen e viktimave.



FJALORI I TERMAVE

Dhuna me armë: Dhuna me armë është përdorimi i qëllimshëm, i kërcënuar ose real i armëve për të shkaktuar vdekjen ose plagosjen. Ajo mund të marrë një sërë formash që variojnë nga dhuna politike tek ajo kriminale dhe ndërpersonale, dhe shfaqet në një mori kontekstesh. Ç’është më e rëndësishmja, ajo shtrihet përtej dëmit fizik, duke përfshirë edhe dëmin psikosocial dhe ndikimin e tij të thellë negativ të zhvillimi.⁷⁰

[\(Promoting development through the reduction and prevention of armed violence: report of the UN Secretary-General\)](#)

Kompensimi: Sipas Direktivës për Kompensimin, viktimat e krimit në BE duhet të kenë të drejtën e një kompensimi të drejtë dhe të përshtatshëm për dëmet që kanë pësuar, pavarësisht se ku është kryer krimi në Komunitetin Evropian (pika 6 e preambulës së direktivës). Nëse një shkelës, me kryerjen e një krimi të dhunshëm, vë në pikëpyetje të drejtat e viktimës ose nuk bën kompensimin e viktimës, kjo e fundit mund të presë me të drejtë që komuniteti i saj ligjor të mbrojë të drejtat e saj për drejtësi në procedurat penale dhe që qeveria të ketë për detyrë ta kompensojë viktimën në vend të shkelësit. (J. Milquet (2019). *Strengthening Victims’ Rights: From Compensation to Reparation – For a new EU Victims’ rights strategy 2020-2025*. Raporti i Këshilltarit të Posaçëm J. Milquet për Presidentin e Komisionit Evropian.)

Viktima e drejtpërdrejtë: Viktimë e drejtpërdrejtë është “një person fizik që ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmin fizik, psikologjik ose emocional, ose humbje ekonomike që është shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale”.

(Direktiva 2012/29/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012)

Anëtarët e familjes: “Anëtarët e familjes” janë bashkëshorti/ja, personi që bashkëjeton me viktimën në një marrëdhënie intime të përkushtuar, në një shtëpi të përbashkët dhe në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, të afërmit në linjë të drejtpërdrejtë, vëllezërit e motrat dhe personat nën kujdestarinë e viktimës.

(Direktiva 2012/29/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012)

Krimi me armë zjarri: Ky term i referohet në mënyrë të posaçme aktiviteteve kriminale që përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit, të tilla si grabitja me armë, mbajtja e paligjshme e armëve të zjarrit dhe vrasjet e lidhura me armët e zjarrit. Ai thekson aspektin e paligjshëm të incidenteve.

[\(Annual Gun Violence Data | Centre for Gun Violence Solutions\)](#)

⁷⁰ Është e rëndësishme të theksohet se juridiksione të ndryshme kanë përkufizime të ndryshme, të cilat varen nga theksi që juridiksionet vendosin mbi aspekte të ndryshme të incidenteve të lidhura me armët e zjarrit, pavarësisht nëse fokusohen te vetë dhuna apo te kriminaliteti i përfshirë. Në Ballkanin Perëndimor, dhuna me armë shpesh lidhet me përhapjen e madhe të armëve të zjarrit të mbajtura nga civilët dhe me historinë e konflikteve në rajon.



Qasja ndaj drejtësisë penale e bazuar tek të drejtat e njeriut: Qasja e bazuar tek të drejtat nis nga supozimi se viktimat e krimeve kundër personit kanë të drejtë për drejtësi dhe se drejtësia penale shërben për të “shpague” dëmin që u është shkaktuar viktimave. Prandaj, viktimat nuk kërkojnë ndihmë në bazë të cenueshmërisë ose nevojave të tyre, por kërkojnë vënien në vend të të drejtave të tyre, dhe juridiksioni si subjekt përgjegjës duhet ta marrë seriozisht detyrën e tij për të mbrojtur të drejtat e njeriut të individëve që jetojnë në territorin e tij.

(J. Milquet (2019). *Strengthening Victims' Rights: From Compensation to Reparation – For a new EU Victims' rights strategy 2020-2025*. Raporti i Këshilltarit të Posaçëm J. Milquet për Presidentin e Komisionit Evropian.)

Viktima jo e drejtpërdrejtë: Viktimat jo të drejtpërdrejta janë “anëtarët e familjes së një personi, vdekja e të cilit është shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale, dhe që kanë pësuar dëm si rezultat i vdekjes së atij personi”. “Anëtarët e familjes” janë bashkëshorti/ja, personi që bashkëjeton me viktimën në një marrëdhënie intime të përkushtuar, në një shtëpi të përbashkët dhe në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, të afërmit në linjë të drejtpërdrejtë, vëllezërit e motrat dhe personat nën kujdestarinë e viktimës.

(Direktiva 2012/29/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012)

Viktima e krimit (duke përfshirë krimin e lidhur me dhunën me armë): “Viktimat” janë “persona që, individualisht ose kolektivisht, kanë pësuar dëm, duke përfshirë dëmtime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose cenim thelbësor të të drejtave të tyre themelore, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve që bien ndesh me ligjet penale që veprojnë brenda shteteve anëtare, duke përfshirë ato ligje që ndalojnë shpërdorimin kriminal të pushtetit.” (Neni A.1). Sipas kësaj Deklarate, një person mund të konsiderohet viktimë pavarësisht nëse autori është identifikuar, kapur, ndjekur penalisht ose dënuar dhe pavarësisht nga marrëdhënia familjare midis autorit dhe viktimës. Termi “viktimë” përfshin gjithashtu, sipas rastit, “rrethin e ngushtë familjar ose personat nën kujdestarinë e viktimës së drejtpërdrejtë dhe personat që kanë pësuar dëm gjatë ndërhyrjes për të ndihmuar viktimat në vështirësi ose për të parandaluar viktimizimin.” (Neni A.2).

(Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit)

Qasja me në qendër viktimën: Një qasje me në qendër viktimën vendos të drejtat dhe dinjitetin e viktimave, duke përfshirë mirëqenien dhe sigurinë e tyre, në krye të të gjitha përpjekjeve. Ajo i referohet një mënyre sistematike të angazhimit me viktimat... Ajo kërkon ofrimin në mënyrë empatike, të individualizuar dhe gjithëpërfshirëse të shërbimeve të vazhdueshme dhe të besueshme në një mënyrë jo paragjyquese dhe jodiskriminuese. Prioriteti është krijimi i një mjedisi i cili u mundëson viktimave që të flasin me një person të besuar në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale, të dëgjohen dhe kuptohen, të ndihen të mbështetur dhe të fuqizuar dhe të mund të shprehin nevojat dhe dëshirat e tyre. Viktimat duhet të jenë të informuara plotësisht në çdo fazë të procesit... dhe të kenë mundësinë që të japin pëlqimin e tyre para se të ndërmerret ndonjë veprim në emër të tyre, duke u dhënë atyre sa më shumë kontroll dhe sens autonomie që të jetë e mundur. Ato duhet të mbrohen nga stigmatizimi, diskriminimi, hakmarrja dhe ritraumatizimi.

([Victims' Rights First | United Nations](#))

Viktimizimi: Procesi i viktimizimit i referohet sulmit të menjëhershëm dhe të gjitha pasojave dhe ndikimeve të drejtpërdrejta të tij.

([RAA_Saxony_Hate_Crime_Victim_Support_in_Europe_2016_m.pdf](#))



Viktimizimi dytësor: Viktimizimi dytësor ndodh kur viktima pëson dëm të mëtejshëm jo si rezultat i drejtpërdrejtë i veprës penale, por për shkak të mënyrës sesi institucionet dhe individët e tjerë e trajtojnë viktimit; për shembull, për shkak të marrjes në pyetje të viktimit në mënyrë të papërshtatshme dhe të përsëritur. Viktimizimi dytësor mund të shkaktohet edhe nga prania e shkelësit gjatë procedurave gjyqësore. Rreziku përshkallëzohet nëse bashkëpunimi dhe koordinimi midis policisë, autoriteteve gjyqësore dhe shërbimeve të mbështetjes është i dobët ose mungon gjatë fazave të ndryshme të procesit penal kur punohet me një viktimitë.

(*Stepping up the response to victims of crime: FRA's findings on challenges and solutions.* <https://fra.europa.eu/en/publication/2024/stepping-response-victims-crime>.)

Shërbimet e specializuara për viktimat: Këto shërbime përfshijnë, të paktën, aksesin në akomodim të sigurt dhe mbështetje psikosociale të personalizuar. Strehat ose format e tjera të strehimit të sigurt duhet të vihen në dispozicion kur ekziston një rrezik i menjëhershëm i riviktimizimit, intimidimit ose hakmarrjes. Mbështetja psikosociale duhet të ofrohet kur një vlerësim identifikon nevoja të posaçme që rrjedhin nga natyra e dhunës ose nga marrëdhënia e viktimit me autorin e krimit - veçanërisht në rastet e dhunës seksuale, dhunës me bazë gjinore ose dhunës nga partneri intim. Në këto raste, mbështetja duhet të përfshijë kujdes të ndjeshëm ndaj traumës dhe këshillim profesional.

(Parafrazuar nga: *Mbështetja për viktimat në shtete të përzgjedhura të Ballkanit: Një perspektivë krahasuese.* Beograd: Victimology Society of Serbia - [Podrska_Zrtvama_Analiza.indd](#))

Viktimizimi i përsëritur (riviktimizimi): Situata kur i njëjti person bie viktimitë e më shumë se një incidenti penal gjatë një periudhe të caktuar kohore.

(European Institute for Gender Equality Glossary - [repeat victimisation | European Institute for Gender Equality](#))

Raportimi nga palë të treta: Raportimi nga palë të treta u mundëson viktimitave, anëtarëve të familjes ose dëshmitarëve që të informojnë një palë të tretë të trajnuar siç duhet – siç janë OShC-të – në lidhje me një krim. Kjo “palë e tretë” pastaj, me pëlqimin e viktimit, mund ta raportojë krimin në polici pa qenë nevoja që viktimat të vihen vetë në kontakt të drejtpërdrejtë me policinë, duke lehtësuar kështu aksesin e viktimitave në mbështetje, mbrojtje dhe drejtësi. Raportimi nga palë të treta është i ndryshëm nga përfaqësimi i viktimitave nga palë të treta në procedura penale.

(*Stepping up the response to victims of crime: FRA's findings on challenges and solutions.* <https://fra.europa.eu/en/publication/2024/stepping-response-victims-crime>)



LITERATURA

Altan, L., Meindre Chautrand, L., Blondé, A., Baudouin-Naneix, S. (2023). *Victims of Crime – Model Provisions Paper: VSE’s vision for a revised victims’ rights directive*. Victim Support Europe.

[1695887426VSEVictimsofCrimeModelProvisionsPaper_Final.pdf](#)

Dokument pune i stafit të Komisionit Evropian (2022). Vlerësimi i Direktivës 2012/29/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 tetor 2012, “Për përcaktimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, dhe për zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/ÇBD” (SWD/2022/0179 final)

[EUR-Lex - 52022SC0179 - EN - EUR-Lex](#)

De Schutter, A. (2023). *Family gun violence in the European Union*. Flemish Peace Institute.

[2023/12/PROJECT_INSIGHT_-_Family_Gun_Violence_DEF_REV.pdf](#)

Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012, “Për përcaktimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, dhe për zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/ÇBD” (Direktiva për të drejtat e viktimave)

[Directive - 2012/29 - EN - EUR-Lex](#)

Ellard, R. & Campbell E. (2020). *Improving support for victims of crime: Key practice insights*, Centre for Innovative Justice, RMIT University

[Improving support for victims of crime, University - Search](#)

European Commission (2020). *EU Strategy on Victims’ Rights 2020-2025*

[eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0258](#)

European Commission (2023). Propozim për një Direktivë të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për ndryshimin e Direktivës 2012/29/BE “Për përcaktimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, dhe për zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/ÇBD

[EUR-Lex - 52023PC0424 - EN - EUR-Lex](#)

European Commission (2023). Propozim për një Direktivë të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për ndryshimin e Direktivës 2012/29/BE “Për përcaktimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, dhe për zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/ÇBD

[EUR-Lex - 52023PC0424 - EN - EUR-Lex](#)

European Union Agency for Fundamental Rights. (2024). *Stepping up the response to victims of crime: FRA’s findings on challenges and solutions*.

<https://fra.europa.eu/en/publication/2024/stepping-response-victims-crime>



J. Milquet (2019). *Strengthening Victims' Rights: From Compensation to Reparation – For a new EU Victims' rights strategy 2020-2025*. Report of the Special Adviser J. Milquet to the President of the European Commission.

[strengthening_victims_rights_-_from_compensation_to_reparation_rev.pdf](#)

Kees, S.J. et al. (2016) *Hate Crime Victim Support in Europe: A Practical Guide*. RAA Sachsen, Dresden

[RAA_Saxony_Hate_Crime_Victim_Support_in_Europe_2016_m.pdf](#)

Krüsselmann K, Aarten P, Liem M (2021) *Firearms and violence in Europe—A systematic review*. PLoS ONE 16(4): e0248955.

<https://journals.plos.org/plosone/article?id=10.1371/journal.pone.0248955>

Nikolić-Ristanović, V., Čopić, S., Nikolić, J., Šaćiri, B. (2018) *Podrška žrtvama u izabranim državama Balkana: Komparativna perspektiva*. Beograd: Viktimološko društvo Srbije (*Mbështetja për viktimat në shtete të përzgjedhura të Ballkanit: Një perspektivë krahasuese*. Beograd: Shoqata e Viktimologjisë e Serbisë. Përmbledhja ekzekutive e disponueshme në anglisht).

[Podrska_Zrtvama_Analiza.indd](#)

OSBE (2019). *Anketa e OSBE-së mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave: Raporti kryesor*. Sekretariati i OSBE-së.

<https://www.osce.org/secretariat/413237>

SEESAC (2024). *In Focus Armed Violence Monitor – Victims of firearms incidents in the Western Balkans*.

https://www.seesac.org/ff/docs/in-focus-armed-violence-monitors_1/In-Focus-Armed-Violence-Monitor-on-Victims-of-Firearm-.pdf

SEESAC (2025). *Incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje – Ballkani Perëndimor, 2019 – 2024*

[IN_FOCUS_Domestic_violence_Western_Balkans_2019-2024_w.pdf](#)

SEESAC (2025). *Analiza mbi Mbështetjen e Viktimave të Dhunës me Armë në Ballkanin Perëndimor (e pabotuar)*

SEESAC (2025). *Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje në Ballkanin Perëndimor: Tendencat kyç dhe shqetësimet kryesore (e pabotuar)*

Veprimi i Koordinuar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Armët e Vogla - CASA (2015). *Standardi Ndërkombëtar për Kontrollin e Armëve të Vogla. Rregullorja kombëtare për aksesin e civilëve në armët e vogla dhe të lehta*.

https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/RuleOfLaw/CivilianAcquisition/UNAgencies_IO/International_Small_Arms_Control_Standards_Inter-Agency_Support_Unit.pdf

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1985). *Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (A/RES/40/34)*.

<https://legal.un.org/avl/ha/dbpjavcap/dbpjavcap.html>

Organizata e Kombeve të Bashkuara (2022). *Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së: Strengthening security sector reform. (S/2022/280)*. Organizata e Kombeve të Bashkuara

[2022_280_english.pdf](#)

Organizata e Kombeve të Bashkuara (2009). *Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së: Promoting development through the reduction and prevention of armed violence. (A/64/228)*.

[Promoting development through the reduction and prevention of armed violence : report of the Secretary-General | Refworld](#)



Shoqata e Viktimologjisë e Serbisë. (2014). *Victims' protection: International law, national legislations and practice – Book of abstracts. Fifth Annual Conference of the Victimology Society of Serbia. Belgrade, Serbia.* [KnjigaApstrakataVGodisnjaKonfVDS2014Eng.pdf](#)

Lidhje të tjera:

[Annual Gun Violence Data | Center for Gun Violence Solutions](#)

[Briefing - Revision of the Victims' Rights Directive](#)

[Data on Guns and Accidental Deaths in the U.S.](#)

[European Network on Victims' Rights](#)

[Standard Reports | Gun Violence Archive](#)

[smallarmssurvey.org/database/global-violent-deaths-gvd](#)

[Victims Rights First | United Nations](#)

[Victims' rights - by country | European e-Justice Portal](#)

[Victim Support Europe](#)